



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 184

**Tiranë – E premte, 26 nëntor 2021**

## PËRMBAJTJA

|                                                                |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | Faqe  |
|----------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 33, datë 24.11.2021 | Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara (amendamenti i dytë), në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet <i>Pfizer Export BV</i> dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave..... | 16641 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 708, datë 24.11.2021      | Për miratimin e rregullores “Për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si bursë DLT”.....                                                                                                                                                                                                                                                                                      | 16641 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 710, datë 24.11.2021      | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.....                                                                                                                                                                                                                                      | 16661 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 712, datë 24.11.2021      | Për lirim nga detyra.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 16663 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 713, datë 24.11.2021      | Për emërim në detyrë.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 16663 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 714, datë 24.11.2021      | Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “Halit Coka”, Bashkia Kamzë, dhe caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese.....                                                                                                                                                                                                                | 16663 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 715, datë 24.11.2021      | Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit e të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Mirditë.....                                                                                                                                                                                 | 16664 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 716, datë 24.11.2021      | Për kalimin te bashkitë Tiranë dhe Shijak të njërive individuale të banimit.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | 16664 |

|                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |       |
|----------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 717, datë 24.11.2021         | Për miratimin e memorandumit të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Drejtoria e Shifrës së Ministrisë së Mbrojtjes, dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të përfaqësuar nga Departamenti i Mbrojtjes, Agjencia e Sigurisë Kombëtare/Shërbimi Qendror i Sigurisë, Drejtoria e Sigurisë Kibernetike dhe Agjencia e Shpërndarjes dhe Kontabilitetit të Komisionit Ushtarak, NATO (DACAN), në lidhje me dhënien e pajisjeve dhe shërbimeve të sigurisë për komunikimin, në kuadrin e infrastrukturës menaxheriale të koduar në Organizatën e Traktatit Atlantik Verior (NATO KMI)..... | 16666 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 720, datë 24.11.2021         | Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës ‘Sabri Kosturi’, Lushnjë”.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | 16666 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 721, datë 24.11.2021         | Për një ndryshim në vendimin nr. 221, datë 12.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil”, të ndryshuar.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | 16668 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 722, datë 24.11.2021         | Për lirim nga detyra të drejtorit ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | 16668 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 723, datë 24.11.2021         | Për emërimin e drejtorit ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | 16668 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 724, datë 24.11.2021         | Për përjashtimin nga procedura e përzgjedhjes nga mësuesit në bazë shkolle të tekstit të abetares.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | 16668 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 725, datë 24.11.2021         | Për funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e Muzeut Kombëtar të Pavarësisë.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | 16669 |
| Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të<br>Apelimit nr. 302, datë 24.11.2021 | Për delegim të përkohshëm kompetencash.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | 16671 |
| Urdhër i ministrit të Brendshëm<br>nr. 370, datë 26.11.2021          | Për delegim kompetence.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | 16671 |

**AKT NORMATIV**  
**Nr. 33, datë 24.11.2021**

**PËR MIRATIMIN E DISA  
NDRYSHIMEVE TË NËNSHKRUARA  
(AMENDAMENTI I DYTË), NË  
MARRËVESHJEN PËR PRODHIMIN  
DHE FURNIZIMIN NGA DHE  
NDËRMJET *PFIZER EXPORT BVD* DHE  
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE  
MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË,  
MINISTRIT TË SHTETIT PËR  
RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË  
SHËNDETIT PUBLIK, MIRATUAR ME  
AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 18.1.2021,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave e të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Neni 1

**Miratimi i disa ndryshimeve**

Miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara (amendamenti i dytë), në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export BV* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

Neni 2

**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**

**VENDIM**  
**Nr. 708, datë 24.11.2021**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES  
“PËR LICENCIMIN E SUBJEKTEVE QË  
USHTROJNË VEPRIMTARINË SI  
BURSË DLT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 4, shkronja “b”, 51, pika 3, dhe 106, pika 1, të ligjit nr. 66/2020, “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, dhe të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullores “Për licencimin e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë si bursë DLT”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**

**RREGULLORE**  
**PËR LICENCIMIN E SUBJEKTEVE**  
**QË USHTROJNË VEPRIMTARINË**  
**SI BURSË DLT**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1  
**Objekti**

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave e të procedurave të detajuara të licencimit, llojit të dokumenteve provuese, mënyrës së shqyrtimit e të vlerësimit të dokumenteve, rregullave të brendshme të funksionimit, si dhe rregullave të detajuara për listimin e tregtimit e tokenëve digjitalë/monedhave virtuale, për



subjektet që ushtrojnë ose kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë si bursë DLT.

## Neni 2 Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të neneve 9, pikat 2 e 3; 15, pika 6; 17, pika 3; 21, pika 5; 59, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 66/2020, “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”.

## Neni 3 Fusha e veprimtarisë

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje i shtrijnë efektet mbi të gjithë personat juridikë, që ushtrojnë ose kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si bursë DLT në territorin e Republikës së Shqipërisë, për klientë që ndodhen brenda territorit të saj ose nga Republika e Shqipërisë, për klientë që ndodhen jashtë saj.

2. Në përputhje me pikën 29, të nenit 3, të ligjit, platformat DLT në të cilat emetohen ose përdoren tokenë digjitale dhe përmes të cilave:

a) mundësohet akses në aplikacione, mallra dhe shërbime të ndryshme; dhe/ose

b) mundësohet shlyerja në fonde e tokenëve digjitale, në mënyrë të drejtpërdrejtë nga emetuesi i tyre,

nuk konsiderohen bursa DLT dhe përjashtohen nga zbatimi i dispozitave të kësaj rregulloreje.

## Neni 4 Përkufizime

Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritetet përgjegjëse”, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

2. “Fonde”, të gjitha asetet, të cilat mbartin një vlerë ekonomike dhe të cilat mund të përdoren si mjet këmbimi kundrejt një asemi tjetër, duke përfshirë këtu tokenët digjitale dhe/ose monedhat virtuale.

3. “Ligji”, ligji nr. 66/2020, “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”.

4. “Dokumente provuese”, i gjithë seti i dokumenteve që dorëzohet pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit nga subjektet kërkuese, me qëllim marrjen e licencës sipas nenit 8, të kësaj rregulloreje, dhe legjislacionit të fuqi.

5. “Programi i monitorimit të përputhshmërisë”, dokumenti i cili parashtron në mënyrë të detajuar të gjitha kontrollet periodike që do të ushtrojë bursa DLT, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.

6. “ZPPPPFT”, zyrtari përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

7. “Libri i urdhrave”, lista e të gjithë urdhrave të hapur të tregtimit brenda bursës DLT, për një çift tregtimi në një periudhë të caktuar.

8. “Marrëveshja *White-Label*”, një marrëveshje delegimi përmes së cilës titullari i licencës bie dakord me palë të treta për përdorimin e plotë ose të pjesshëm të *software*-ëve të tyre, sipas modelit *software*-i si një shërbim.

9. “MTI” nënkupton marrëveshjen e teknologjisë inovative, sipas përkufizimit të pikës 42, të nenit 3, të ligjit.

10. “OSHI”, ofruesi i shërbimeve inovative, në përputhje me përkufizimin e pikës 40, të nenit 3, të ligjit.

11. “Personel kyç”, çdo individ/person fizik i cili mban një ose më shumë nga funksionet e mëposhtme në shoqërinë e subjektit kërkuar/bursës DLT:

a) drejtori i Departamentit të Financës;

b) drejtori i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë Kibernetike;

c) drejtori i Departamentit të Përputhshmërisë;

ç) drejtori i Departamentit të Parandalimit të Pastrimit të Parave/zyrtari përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

d) drejtori i Departamentit të Administrimit të Rrezikut;

dh) drejtori i Departamentit të Auditimit të Brendshëm.

12. “Plani për vazhdimësinë e biznesit”, dokumenti i përgatitur nga subjekti kërkuar/titullari i licencës si bursë DLT, ku pasqyrohen të gjitha procedurat dhe masat që do të ndërmerren në rastet e emergjencave potenciale, me qëllim



sigurimin e vazhdimësisë operationale të biznesit, në përputhje me detyrimet e tij rregullatore.

13. “Politika e menaxhimit të likuiditetit”, dokumenti i përgatitur nga subjekti kërkuar/titullari i licencës, ku parashtrohen të gjitha rregullat dhe procedurat për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit brenda shoqërisë.

14. “Politika e menaxhimit të rrezikut”, dokumenti i përgatitur nga subjekti kërkuar/titullari i licencës, ku parashtrohen të gjitha rregullat dhe masat e ndërmarra në kuadër të identifikimit të rrezikut që lidhet me veprimtarinë, sistemet dhe procedurat e shoqërisë, duke përcaktuar, aty ku është e përshtatshme, edhe nivelin e rrezikut që është i tolerueshëm nga ana e shoqërisë.

15. “Politika e trajtimit të ankesave”, dokumenti i përgatitur nga subjekti kërkuar/titullari i licencës, ku pasqyrohen të gjitha rregullat dhe procedurat për trajtimin dhe adresimin e ankesave të klientëve të tij.

16. “Pranimi për tregtim”, procesi përmes së cilit bursa DLT liston tokenin digjital/monedhën virtuale në platformën e saj dhe i mundëson klientëve të saj të kryejnë transaksione me tokenin digjital/monedhën virtuale, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje dhe legjislacionit në fuqi.

17. “Software-i si një shërbim”, një model i ofrimit të *software*-ëve për përdorim përmes abonimeve, i cili mirëmbahet në mënyrë të centralizuar.

18. “Tregtim i bazuar në parimin e përputhshmërisë” (*matched principal trading*), transaksioni, në të cilin ndërmjetësi vendoset midis blerësit dhe shitësit të transaksionit, në mënyrë të tillë që të mos ekspozohet asnjëherë ndaj rrezikut të tregut gjatë ekzekutimit të transaksionit, ku të dyja anët e transaksionit ekzekutohen njëkohësisht dhe ku transaksioni kryhet me një çmim që nuk i sjell ndërmjetësit asnjë fitim ose humbje, përveç një tarife ose komisioni mbi transaksionin, i cili i është bërë i ditur më parë.

19. “Tregtimi për llogari të vet”, tregtimi duke përdorur fondet e veta të bursës DLT, që rezulton në mbylljen e transaksioneve me një ose më shumë instrumente financiare.

Të gjitha përkufizimet e listuara në nenin 3, të ligjit nr. 66/2020, “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë rregullore.

## Neni 5

### Dispozita të përgjithshme

1. Në përputhje me nenin 4, të ligjit, autoritetet përgjegjëse lëshojnë licencën si bursë DLT për të gjitha subjektet që përmbushin kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta të përcaktuara në ligj dhe këtë rregullore, sipas kategorive të mëposhtme:

a) licenca e kategorisë “A”, ku mund të tregtohen vetëm tokenë digjitale shërbimesh, tokenë digjitale asetesh dhe tokenë digjitale pagesash, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 57, të ligjit;

b) licenca e kategorisë “B”, ku krahas veprimtarisë së lejuar për kategorinë “A”, mund të tregtohet gjithashtu para FIAT dhe monedha virtuale, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 58, të ligjit;

c) licenca e kategorisë “C”, ku krahas veprimtarisë së lejuar për kategoritë “A” dhe “B”, mund të tregtohen gjithashtu, edhe tokenë digjitale të titujve, në përmbushje të detyrimeve të parashikuara në nenin 59, të ligjit.

2. Bursa DLT ndalohet të kryejë tregtim për llogari të vet dhe tregtim bazuar në parimin e përputhshmërisë.

## Neni 6

### Emërimi i agentit TD dhe OSHI

1. Subjekti kërkuar emëron një agjent TD, i cili harton dhe dorëzon kërkesën për licencim, në emër dhe për llogari të subjektit kërkuar. Agjenti TD ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me përcaktimet e krerëve III dhe V, të ligjit dhe rregulloreve përkatëse.

2. Në rastet kur subjekti kërkuar ose titullari i licencës, në kuadër të veprimtarisë së tij, vendos të implementojë një marrëveshje të teknologjisë inovative, atëherë ai emëron një ofrues të shërbimeve inovative për të kryer detyrat e auditimit të sistemeve teknologjike, sipas përcaktimeve të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi.

3. Subjekti kërkuar sigurohet që të gjitha komunikimet, njoftimet, mbledhjet dhe dorëzimet e dokumenteve të kryhen përmes agjentit TD të emëruar dhe OSHI-t, sipas rastit.

4. Subjekti kërkuar vepron gjithnjë në mënyrë bashkëpunuese me agjentin TD dhe OSHI-n dhe i



vendos në dispozicion, pa vonesa, të gjithë informacionin e kërkuar prej tyre.

#### Neni 7

##### Shqyrtimi i kërkesës për licencim

1. Pas marrjes në dorëzim të kërkesës për licencim dhe paketës së dokumenteve provuese, autoritetet përgjegjëse ngrenë komisionin e përbashkët, i cili do të kryejë shqyrtimin dhe vlerësimin e tyre, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe legjislacionit në fuqi. Rregullat për funksionimin dhe organizimin e komisionit përcaktohen me urdhër të përbashkët të autoriteteve përgjegjëse. Në çdo rast kur e vlerëson të nevojshme, komisioni mund të thërrasë për mendim edhe përfaqësues nga institucione të tjera.

2. Autoriteti përgjegjës mbështet vendimmarrjen e tij mbi këto parime të përgjithshme:

- a) mbrojtjen e interesave të investitorëve dhe interesit publik;
- b) nxitjen e qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve financiare;
- c) sigurimin e respektimit të ligjit;
- ç) sigurinë e sistemeve;
- d) sigurinë e mbrojtjes nga sulmet kibernetike.

3. Gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës për licencim, autoriteti vlerëson dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti kërkuar, duke marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- a) përmbushjen e kriterëve për përshtatshmëri dhe aftësi të aksionarëve, administratorit, anëtarëve të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës, si dhe personelit kyç sipas kërkesave të ligjit dhe të kësaj rregulloreje;
- b) përputhshmërinë e subjektit kërkuar me kërkesat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje;
- c) kapacitetin dhe aftësinë e subjektit kërkuar për të ruajtur dhe plotësuar në të ardhmen kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta të ligjit dhe kësaj rregulloreje.

#### Neni 8

##### Dhënia e licencës

1. Në rastet kur autoriteti, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikimit për licencë, sipas përcaktimeve të nenit 7, të kësaj rregulloreje, gjykon se subjekti kërkuar i përmbush të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore për të ushtruar veprimtarinë si bursë

DLT, sipas kategorive të përcaktuara në shkronjën “b”, të nenit 4, të ligjit, lëshon licencën e bursës DLT në emër të subjektit kërkuar, sipas afateve të përcaktuara në nenin 11, të ligjit.

2. Në vendimin për licencim të bursës DLT, autoriteti përfshin vendimin për miratimin e:

- a) zotëruesit të pjesëmarrjes influencuese;
- b) emërimit të administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç.

3. Autoriteti publikon vendimin për dhënien e licencës në faqen e tij zyrtare dhe e regjistron atë në regjistrin e bursave DLT, sipas përcaktimeve të neneve 22 dhe 24, të ligjit, dhe në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve sipas nenit 14, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### Neni 9

##### Refuzimi i kërkesës për licencim

Në përputhje me nenin 13, të ligjit, autoriteti refuzon kërkesën për licencim në rastet kur:

- a) subjekti kërkuar nuk ka kryer pagesën e tarifës së aplikimit për licencë, referuar rregullores së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare;
- b) autoriteti gjykon, mbi baza të arsyeshme, se subjekti kërkuar ka dorëzuar dokumente dhe/ose informacion të rremë, të pasaktë ose jo të plotë;
- c) autoriteti gjykon, mbi baza të arsyeshme, se dokumentet e dorëzuara nga subjekti kërkuar janë të pamjaftueshme dhe/ose subjekti kërkuar nuk përmbush kushtet e kriteret për licencim;
- ç) autoriteti gjykon, mbi baza të arsyeshme, se subjekti kërkuar nuk do të jetë i aftë të plotësojë në të ardhmen kushtet e kriteret për licencim.

#### Neni 10

##### Transferimi i licencës

1. Titullari i licencës nuk mund të delegojë ose ta transferojë licencën te një palë e tretë, pa miratimin paraprak me shkrim të autoritetit përgjegjës.

2. Titullari i licencës duhet të njoftojë paraprakisht autoritetin përgjegjës për çdo qëllim të tijin, lidhur me delegimin ose transferimin e licencës te një palë e tretë.



3. Autoriteti miraton ose refuzon delegimin apo transferimin e licencës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e njoftimit. Në çdo rast, miratimi i delegimit apo transferimit të licencës bëhet vetëm nëse personi juridik, të cilit kërkohet t'i delegohet apo transferohet licenca, plotëson kushtet e përcaktuara nga ligji.

4. Çdo delegim ose transferim i licencës në kundërshtim me këtë nen konsiderohet si akt absolutisht i pavlefshëm.

5. Autoriteti mund të pezullojë ose të heqë licencën e titullarit në rast të shkeljes së këtij neni.

#### Neni 11

### Heqja dorë vullnetarisht nga licenca

1. Titullari i licencës së bursës DLT mund të heqë dorë vullnetarisht nga licenca e tij, duke dorëzuar pranë autoritetit njoftimin për dorëzimin e licencës, sipas formatit të përcaktuar në shtojcën përkatëse.

2. Njoftimi për dorëzimin e licencës duhet të shoqërohet me dokumente ose deklarata noteriale, sipas rastit, që vërtetojnë se bursa DLT:

a) ka përfunduar të gjitha shërbimet ndaj klientëve aktualë;

b) nuk ka detyrime kundrejt palëve të treta;

c) nuk është palë ndërgjyqëse në procese gjyqësore në Shqipëri;

ç) konfirmon ruajtjen në vijimësi të fondeve të veta, për të paktën 6 (gjashtë) muaj;

d) ka trajtuar ankesat e mundshme ndaj tij, në përputhje me politikat dhe rregullat e brendshme të tij, dhe se nuk ka asnjë ankesë të patrajtuar.

#### KREU II

### DOKUMENTET PROVUESE

#### Neni 12

### Përmbajtja e paketës së dokumenteve provuese

1. Çdo subjekt kërkues, i cili kërkon të ushtrojë veprimtarinë si bursa DLT, duhet të plotësojë dhe të dorëzojë kërkesën për licencim, sipas formatit të përcaktuar në shtojcën përkatëse. Kërkesës për licencim i bashkëlidhet paketa e dokumenteve provuese, sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar në ligj dhe në këtë rregullore.

2. Gjatë hartimit të kërkesës për aplikim, subjekti kërkues duhet të sqarojë nëse modeli i tij i biznesit aplikon:

a) modelin e ekzekutimit, përputhjes së urdhrave dhe transferimit të aseteve, bazuar mbi librin e urdhrave;

b) ekzekutimin e urdhrave direkt në regjistrat e shpërndarë;

c) një model hibrid të dy opsioneve të mësipërme.

3. Kërkesa plotësohet dhe nënshkruhet nga përfaqësuesi/t ligjor/ë të subjektit kërkues, si dhe nga çdo individ sipas kërkesave të seksioneve përkatëse.

4. Paketa e dokumenteve provuese përbëhet nga:

a) dokumentet mbi organizimin dhe veprimtarinë e shoqërisë;

b) dokumentet mbi besueshmërinë/ reputacionin e subjektit kërkues dhe burimin e kapitalit;

c) dokumentet në lidhje me politikat, rregulloret e brendshme, procedurat dhe sistemet e shoqërisë;

ç) dokumentet mbi plotësimin e kriterëve të kapitalit minimal fillestar dhe fondeve të veta të shoqërisë;

d) dokumentet mbi plotësimin e kriterëve të aftësisë dhe përshtatshmërisë dhe njohurive të duhura teknike.

5. Dokumentet provuese, pjesë përbërëse të paketës së dokumenteve, duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara jo më parë se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes në autoritet dhe të shoqëruara, sipas rastit, me vulë apostile, sipas kërkesave të ligjit nr. 9060, datë 8.5.2003, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja". Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti ose të dorëzimit të dokumenteve të pasakta përbëjnë shkak për refuzimin e kërkesës për licencim.

#### Neni 13

### Dokumentet mbi organizimin dhe veprimtarinë e shoqërisë

1. Dokumentet mbi krijimin dhe organizimin e subjektit përmbajnë, si më poshtë:

a) ekstraktin e regjistrimit në QKB të subjektit kërkues;



b) statutin, ku objekti i veprimtarisë dhe kapitali minimal të përputhen me veprimtarinë, për të cilat subjekti kërkon të licencohet, si dhe të përshkruhet roli i anëtarëve të pavarur të këshillit të administrimit, shoqëruar me një përshkrim të detyrave e të përgjegjësisë të tyre;

c) listën e shërbimeve dhe aktiviteteve që synohen të kryhen;

ç) strukturën organizative/organigramën e shoqërisë, me përshkrimin mbi funksionet dhe përgjegjësitë e personelit kyç;

d) planin e biznesit së paku për tri vitet e para të aktivitetit, duke përfshirë këtu përshkrimin e veprimtarisë së subjektit, perspektivat e zhvillimit të veprimtarisë, pritshmëritë e subjektit mbi veprimtarinë që do të kryejë, mënyrën e përmbushjes së kërkesave për mjaftueshmëri kapitali. Plani i biznesit duhet të përfshijë edhe elementet e mëposhtme:

i. planin e marketingut të shoqërisë, përfshirë klientët e synuar;

ii. planin financiar, duke përfshirë një përshkrim se si do të mbulohet kostoja e fillimit të veprimtarisë dhe se si do të ruhen dhe zbatohen kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit;

iii. programin për trajnimin e vazhdueshëm të të gjithë personelit, për të përmbushur standardet për aftësitë profesionale, siç parashikohen në ligj dhe në rregulloret e miratuara në zbatim të tij;

dh) deklaratën e përgjegjësisë, ku të përshkruhen përgjegjësitë e funksionarëve të cilësuar si personel kyç, si dhe përshkrimin e funksioneve dhe përgjegjësisë kryesore, në rastet kur një funksionar do të ushtrojë më shumë se një funksion të përcaktuar për personelin kyç;

e) vërtetimin bankar që konfirmon pagesën në lekë, për llogari të shoqërisë, të kapitalit minimal fillestar, në përputhje me nenet 57, 58 dhe 59, të ligjit, i cili duhet të mbahet i bllokuar në favor të autoritetit, në një nga bankat në Republikën e Shqipërisë. Kjo shumë zhbllokohet nëpërmjet njohfimit të autoritetit, në përfundim të procedurës së licencimit;

ë) nëse shoqëria ka ushtruar një aktivitet tjetër përpara kërkesës për të ushtruar veprimtarinë si bursë DLT, përveç dokumenteve të sipërpërmendura, duhet të depozitojë, gjithashtu:

i. pasqyrat financiare të audituara për 3 (tri) vitet e fundit dhe, në rastin e një shoqërie më të re, pasqyrat që nga krijimi;

ii. vërtetimin nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;

iii. deklaratën se shoqëria nuk është nën hetim dhe/ose proces gjyqësor për kryerjen e ndonjë veprë penale.

Neni 14

### **Dokumentet mbi reputacionin dhe burimin e kapitalit**

1. Dokumentet mbi aksionarët dhe burimin e kapitalit përmbajnë, si më poshtë:

a) strukturën aksionare të kapitalit të shoqërisë;

b) për aksionarët me pjesëmarrje influencuese në shoqërinë kërkuese, një përmbledhje e veprimtarisë/aktivitetit të tyre;

c) të dhëna për shoqëri të tjera, ku aksionari me pjesëmarrje influencuese në shoqërinë e bursës DLT është aksionar/ortak kryesor ose ushtron kontroll;

ç) strukturën dhe listën e aksionarëve përfitues fundorë të shoqërisë.

2. Të dhënat për integritetin dhe burimin e kapitalit përfshijnë:

2.1 Kur aksionari është person juridik, subjekti kërkues duhet të depozitojë:

a) ekstraktin e regjistrimit në QKB;

b) pasqyrat financiare të audituara për 3 (tri) vitet e fundit dhe, në rastin e një shoqërie më të re, pasqyrat që nga krijimi;

c) dokument të lëshuar nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;

ç) vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë, për gjendjen e kredive në sistemin bankar;

d) deklaratë se shoqëria nuk është nën hetim dhe/ose proces gjyqësor për kryerjen e ndonjë veprë penale;

dh) dokument se shoqëria nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera.

2.2 Kur aksionari është individ, subjekti kërkues duhet të depozitojë:

a) dokument identifikimi (ID/pasaportë);

b) *curriculum vitae*;

c) diploma, kualifikime, trajnime;

ç) dëshmi të burimeve të krijimit të kapitalit, si blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka dhe/ose degë të bankave të huaja apo dëshmi të tjera për burimin e krijimit të kapitalit;



d) dokument të lëshuar nga administrata tatimore mbi gjendjen e detyrimeve tatimore;

dh) vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar;

e) dokumente të lëshuara nga organet kompetente, si më poshtë:

i. vërtetim i gjendjes gjyqësore;

ii. vërtetim nga prokuroria për hetim penal në proces;

iii. vërtetim nga gjykata për çështje gjyqësore në proces;

iv. dokument, lidhur me procese ekzekutimi të detyrueshëm apo për detyrime pasurore të pashlyera;

v. deklaratë personale për lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi, sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë sipas shtojcës përkatëse.

3. Dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, plotësohet edhe nga aksionarët e aksionarit, person juridik me pjesëmarrje influencuese, që zotërojnë mbi 30% të aksioneve me të drejtë vote. Kjo kërkesë duhet të plotësohet nga bursa DLT gjatë gjithë kohës së vlefshmërisë së licencës.

#### Neni 15

##### **Politikat, rregulloret, procedurat dhe sistemet e brendshme të shoqërisë**

Dokumentet mbi rregulloret, politikat, procedurat dhe sistemet e brendshme të shoqërisë së subjektit kërkuar, të cilat shqyrtohen nga autoriteti, duhet të përmbajnë:

a) rregulla të brendshme mbi parandalimin dhe trajtimin e konfliktit të interesave;

b) rregulla të brendshme mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;

c) rregulla të brendshme në lidhje me delegimin e funksioneve/detyrave;

ç) rregulla të brendshme në lidhje me sigurinë kibernetike;

d) rregulla të brendshme mbi përshtatshmërinë e klientit;

dh) rregulla të brendshme për menaxhimin e rrezikut dhe likuiditetit;

e) rregulla të brendshme për trajtimin e ankesave;

ë) rregulla të brendshme për parandalimin e abuzimit të tregut;

f) rregulla të brendshme për raportimin e shkeljeve;

g) rregulla të brendshme për listimin e tokenëve digjitalë/monedhave virtuale;

gj) rregulla të brendshme për ruajtjen e të dhënave;

h) rregulla të brendshme për vazhdimësinë e biznesit;

i) rregulla të brendshme për sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemeve;

j) rregulla të brendshme për kujdestarinë e aseteve, në rast se është e aplikueshme.

#### Neni 16

##### **Parandalimi dhe trajtimi i konfliktit të interesit**

1. Në përputhje me nenin 52, të ligjit, subjekti kërkuar ose bursa DLT duhet të dorëzojë pranë autoritetit një vetëdeklarim, përmes të cilit duhet të konfirmojë se:

a) bursa DLT është e pavarur nga emetuesit e tokenëve digjitalë/monedhave virtuale që tregtohen në bursën DLT dhe nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me emetuesit në fjalë;

b) veprimtaria e bursës DLT ka qenë dhe do të vijojë të jetë në përputhje me detyrimet e përcaktuara në rregulloret e brendshme të tij, për parandalimin e konfliktit të interesit, duke evidentuar në mënyrë të rregullt të gjitha rastet e mospërputhshmërisë.

2. Bursa DLT do të konsiderohet të jetë në kushtet e konfliktit të interesit në rastet kur:

a) një ose më shumë nga funksionarët e bursës DLT ushtron një nga funksionet e përcaktuara në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, në kundërshtim me dispozitat e atij ligji;

b) një ose më shumë nga funksionarët e bursës DLT gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, të përcaktuara në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

3. Bursa DLT harton rregullore të brendshme efektive për parandalimin dhe trajtimin e konfliktit të interesave, e cila është proporcionale me madhësinë, strukturën, kompleksitetin dhe



mënyrën e organizimit të shoqërisë së bursës DLT, dhe i përmbahet përcaktimeve të saj në vijimësi. Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesave përditësohet në mënyrë periodike të paktën një herë në vit.

4. Bursa DLT regjistron, rast pas rasti, të gjitha konfliktet e interesave të funksionarëve të saj. Për regjistrimin e konflikteve, rast pas rasti, të interesave të funksionarëve të bursës DLT krijohet regjistri me të njëjtin emër.

5. Regjistri i konfliktit të interesave të funksionarëve të bursës DLT përmban minimalisht të dhënat e mëposhtme:

- a) identitetin e funksionarit;
- b) interesat private të tij;
- c) shkakun e konfliktit të interesit;
- ç) thelbin e këtij konflikti;
- d) palët e interesuara që janë përfshirë në të;
- dh) burimin e të dhënave;
- e) mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre.

Neni 17

#### **Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit**

Bursa DLT është subjekt i rregullores së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nr. 58, datë 30.6.2015, “Mbi masat e vigjencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, si dhe zbaton me përpikëri të gjitha detyrimet e përcaktuara për ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Neni 18

#### **Delegimi i funksioneve dhe detyrave**

1. Në rastet kur bursa DLT delegon një pjesë të funksioneve ose detyrave të saj te një palë e tretë, bursa DLT duhet të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për të evituar rreziqet operationale, si dhe për të ruajtur një nivel të përshtatshëm të ofrimit të shërbimit ndaj klientëve të saj.

2. Bursa DLT është përgjegjëse për cilësinë e shërbimit të ofruar dhe për të gjitha dëmet ose pasojat që mund të shkaktohen si rrjedhojë e delegimit të detyrave të saj te një palë e tretë.

3. Bursa DLT ose subjekti kërkues, si pjesë e paketës së dokumenteve, duhet të hartojë dhe të përditësojë në vijimësi rregullore të brendshme dhe procedura, në lidhje me delegimin e funksioneve dhe/ose detyrave te palët e treta, të cilat duhet të përfshijnë qasjen e bursës DLT ndaj delegimit, planet e emergjencës, strategjitë e daljes, rastet kur delegimi kryhet brenda së njëjtës strukturë korporative, si dhe rregulla të përgjithshme që mbulojnë të gjitha aspektet e delegimit të funksioneve dhe/ose detyrave. Rregullat e brendshme duhet të përmbajnë, gjithashtu, informacion në lidhje me ndërmarrjen e masave të arsyeshme për të shmangur riskun operational në rastet e delegimit të funksioneve të rëndësishme.

4. Gjatë delegimit të funksioneve ose detyrave të saj, bursa DLT duhet të sigurojë se:

a) delegimi nuk ndikon në marrëdhënien e bursës DLT me klientët e saj, duke përfshirë këtu detyrimet e bursës DLT kundrejt tyre;

b) delegimi nuk ndikon në kushtet e licencimit të bursës DLT;

c) palët e treta, të cilave i delegohen një ose më shumë funksione apo detyra, do të veprojnë gjithnjë në mënyrë bashkëpunuese me autoritetin. Delegimi i funksioneve dhe/ose detyrave nuk duhet të cenojë veprimtarinë mbikëqyrëse të autoritetit kundrejt titullarit të licencës, përfshirë këtu qasjen e autoritetit në selitë e palëve të treta për të ushtruar funksionet mbikëqyrëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) bursa DLT do të ketë ekspertizën e duhur për të vlerësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara nga pala e tretë dhe për të mbikëqyrur në mënyrë efektive shërbimet e deleguara;

d) bursa DLT do të ketë qasje të menjëhershme në informacionin përkatës, në lidhje me shërbimet e deleguara;

dh) palët e treta, të cilave i delegohen një ose më shumë shërbime, janë në përputhje me standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;

e) ka njoftuar autoritetet përgjegjëse dhe ka marrë miratimin e tyre për delegimin.

5. Çdo marrëveshje për delegimin e funksioneve dhe/ose detyrave duhet të jetë e noterizuar dhe duhet të përmbajë qartazi të drejtat dhe detyrimet e secilës palë.



## Neni 19

**Politikat dhe rregulloret për menaxhimin e riskut dhe likuiditetit**

1. Bursa DLT ose subjekti kërkues, sipas rastit, emëron një person si menaxher risku, funksion i cili duhet të jetë i pavarur nga funksione të tjera të shoqërisë. Funksionet e administruesit të riskut mund të kryhen nga persona brenda strukturës së shoqërisë së subjektit kërkues ose bursës DLT, sipas rastit, ose mund të nënkontraktohen te shoqëri të cilat zotërojnë ekspertizën e duhur për të ushtruar këtë veprimtari.

2. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, administruesi i riskut harton politika, vendos dhe mirëmban sisteme për administrimin e riskut, të cilat duhet të përmbushin funksionet e mëposhtme:

a) zbatimin e politikave dhe rregulloreve të shoqërisë për menaxhimin e riskut;

b) hartimin e raporteve, udhëzimeve teknike dhe këshillimin e bordit drejtues, këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit dhe personave të tjerë në nivele të larta drejtuese, në lidhje me çdo vendim që mbart rrezik material;

c) hartimin dhe zhvillimin e strategjisë së menaxhimit të riskut dhe likuiditetit;

ç) informimin e menjëhershëm dhe raportimin pranë bordit drejtues, këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit, në lidhje me çështje të administrimit të riskut.

3. Bordi drejtues/këshilli miraton dhe shqyrton periodikisht strategjinë dhe politikat e menaxhimit të riskut dhe likuiditetit, më qëllim identifikimin e riskut të ekspozuar, monitorimin dhe trajtimin e tij në mënyrë sa më efektive.

## Neni 20

**Përshtatshmëria e klientëve**

1. Krahas detyrimeve, në kuadër të legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe pastrimin e parave, bursa DLT i kërkon klientëve të saj të gjithë informacionin e nevojshëm me qëllim klasifikimin e tyre si klient profesionist ose joprofesionist, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit.

2. Bursa DLT vendos rregulla specifike për të mundësuar vetëm klientët e klasifikuar si profesionistë të veprojnë si krijues tregu dhe/ose ofrues likuiditeti në platformë, në përputhje me

termat e publikuar në faqen e internetit. Klasifikimi si klient profesionist i ofron këtij të fundit një nivel të ndryshëm shërbimesh, tarifash, kompensimi dhe mbrojtjeje në krahasim me një klient joprofesionist.

3. Bursa DLT harton një marrëveshje standarde e cila i vendoset në dispozicion cilitdo klient që dëshiron të regjistrohet në platformën e bursës DLT. Marrëveshja standarde duhet të përmbajë të paktën:

a) identitetin e palëve në marrëveshje;

b) llojin e shërbimit të ofruar;

c) kostot dhe tarifat, në lidhje me shërbimin e ofruar;

ç) metodat e komunikimit ndërmjet bursës DLT dhe klientit, duke përfshirë këtu sistemin e autentifikimit të klientit;

d) një përshkrim të sistemeve të sigurisë në përdorim nga ana e bursës DLT;

dh) të drejtat e anulimit të kontratës;

e) një përshkrim, në gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme, në lidhje me rreziqet potenciale të asociuara me shërbimet e ofruara;

ë) të drejtat e klientit për të paraqitur ankesa, në përputhje me politikat dhe rregulloret e trajtimit të ankesave të bursës DLT;

f) ligjin e zbatueshëm.

## Neni 21

**Politikat dhe rregulloret për parandalimin e mashtrimit dhe abuzimit me tregun**

Subjekti kërkues ose titullari i licencës, sipas rastit, harton dhe dorëzon, si pjesë të paketës së dokumenteve, politikat dhe rregulloret e shoqërisë për parandalimin e mashtrimit dhe abuzimit me tregun, të cilat duhet të përmbajnë:

a) rregulla për trajtimin e informacionit të brendshëm;

b) procedura në lidhje me publikimin e informacioneve;

c) rregulla për parandalimin e tregtimit bazuar në informacionin e privilegjuar;

ç) rregulla në lidhje me kumbuesit e tregut;

d) strukturën e kontrollit të përputhshmërisë brenda shoqërisë.



## Neni 22

**Politikat dhe rregulloret për raportimin e shkeljeve**

1. Titullari i licencës harton politika dhe rregulla të brendshme për raportimin e shkeljeve nga nëpunësit e tyre ose palë të treta, nëpërmjet një kanali komunikimi të pavarur, nën varësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.

2. Politikat dhe rregullat e brendshme të përmendura në këtë nen duhet të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi për sinjalizuesit dhe mbrojtjen e tyre.

## Neni 23

**Politikat dhe rregulloret për trajtimin e ankesave**

1. Subjekti kërkuar ose titullari i licencës, sipas rastit, harton dhe dorëzon si pjesë të paketës së dokumenteve, politikat dhe rregulloret e shoqërisë për trajtimin efektiv dhe të njëtrajtshëm të ankesave. Procedura e trajtimit të ankesave duhet të jetë pa pagesë, si dhe të pasqyrohet në faqen e internetit të subjektit kërkuar dhe në marrëveshjen standarde me klientin.

2. Subjekti kërkuar emëron një ose më shumë persona përgjegjës për trajtimin e ankesave të klientëve brenda afateve të arsyeshme kohore, të cilat në çdo rast nuk duhet të tejkalojnë 30 (tridhjetë) ditë pune nga data e marrjes së ankesës.

3. Bursa DLT mban një regjister të të gjitha ankesave të dërguara ku pasqyrohet edhe mënyra e trajtimit të tyre.

## Neni 24

**Politikat dhe rregulloret për ruajtjen e të dhënave**

1. Krahas parashikimeve të kuadrit ligjor në fuqi për ruajtjen e të dhënave, bursa DLT ka detyrimin e ruajtjes së të gjitha të dhënave të nevojshme për të vërtetuar përputhshmërinë e saj, për të paktën 5 (pesë) vjet. Me kërkesë të autoriteteve, titullari i licencës, brenda 72 orëve, vendos në dispozicion të dhënat e kërkuara.

2. Në përmbushje të detyrimeve të këtij neni, bursa DLT harton politika dhe rregulla për ruajtjen e të dhënave, të cilat përmbajnë të paktën:

a) ruajtjen e të gjitha transaksioneve që janë kryer në bursën DLT;

b) të dhëna të të gjitha faturave dhe pagesave të klientëve që rrjedhin nga transaksionet e kryera në bursën DLT;

c) të dhëna të cilat mundësojnë identifikimin e aktiveve dhe pasiveve, të cilat janë procesuar nga bursa DLT për llogari të klientëve të saj, në mënyrë të vazhdueshme;

ç) të dhëna të cilat mundësojnë identifikimin e vendndodhjes së aseteve të klientëve, pronarëve fundorë të tyre dhe informacionin nëse ekziston ndonjë detyrim ndaj tyre, për të cilat bursa DLT është vënë në dijeni.

3. Të dhënat e mësipërme mund të ruhen edhe elektronikisht, duke ndërmarrë masat e duhura që kjo mënyrë e ruajtjes së të dhënave t'i mundësojë autoriteteve përgjegjëse dhe audituesve të emëruar një qasje të shpejtë të informacionit.

4. Në rast se titullari i licencës vendos ruajtjen e të dhënave në format elektronik, infrastruktura e sistemeve të përdorura duhet të sigurojë:

a) integritetin dhe sigurinë e të dhënave të ruajtura;

b) disponueshmërinë, gjurmueshmërinë dhe qasjen e shpejtë ndaj të dhënave;

c) privatësinë dhe konfidencialitetin;

ç) qasjen ndaj të dhënave në mënyrë të shpejtë dhe në format të lexueshëm nga autoritetet përgjegjëse dhe audituesit e emëruar, duke i mundësuar këtyre të fundit rikostituimin e secilës fazë të procesimit të transaksioneve;

d) parandalimin e manipulimit dhe/ose ndryshimit të të dhënave.

## Neni 25

**Përputhshmëria e të dhënave**

1. Titullari i licencës vendos dhe mirëmban sisteme të përshtatshme, të cilat i sigurojnë në mënyrë automatike, periodikisht, të paktën 1 herë në muaj, përputhshmërinë e fondeve të klientëve me:

a) të dhënat e disponuara për atë klient; dhe

b) me të dhënat për subjektet që eventualisht i mbajnë dhe ruajnë këto fonde.

2. Krahas detyrimeve për raportimin e shkeljeve, në rast të konstatimit të mospërputhjeve midis të dhënave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, titullari i licencës është i detyruar të ruajë të



dhënat e këtyre mospërputhjeve dhe hapat që janë ndërmarrë nga ana e tij për t'i adresuar ato.

#### Neni 26

##### **Politikat dhe sistemet në kuadër të sigurisë kibernetike**

1. Subjekti kërkues ose titullari i licencës, sipas rastit, harton politika, si dhe vendos e mirëmban sisteme të qëndrueshme, në kuadër të sigurisë kibernetike, për të garantuar ruajtjen, vërtetimin dhe transferimin e sigurt të informacionit, në mënyrë që të zvogëlojë rrezikun e humbjes së të dhënave, duke përfshirë këtu korrupsionin e të dhënave, si dhe të synojë të parandalojë qasjen e paaautorizuar dhe të parandalojë rrjedhjen e informacionit me synimin për të siguruar konfidencialitetin e të dhënave pronësore dhe të palëve të treta në çdo kohë.

2. Politikat dhe procedurat përkatëse për vendosjen e këtyre sistemeve hartohen si seksion i veçantë brenda dokumentit të politikave dhe rregullave për menaxhimin e riskut dhe nënshkruhen nga menaxheri i riskut dhe drejtuesi i departamentit të teknologjisë së informacionit.

3. Politikat dhe rregullat e brendshme, në kuadër të sigurisë kibernetike, duhet të përmbajnë të paktën:

a) periodicitetin, metodologjinë dhe mënyrën e ruajtjes së të dhënave të testeve të penetrimit të aplikueshme, me qëllim vlerësimin e qëndrueshmërisë së sistemeve teknologjike;

b) personin/at përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë së sistemeve me politikat dhe rregullat e sigurisë kibernetike të titullarit të licencës;

c) detyrimin për të shqyrtuar periodikisht, të paktën një herë në vit, përmbajtjen e politikave dhe rregullave në kuadër të sigurisë kibernetike, me qëllim përditësimin e tyre në përputhje me praktikën më të mira në këtë fushë.

#### Neni 27

##### **Politikat dhe rregullat për vazhdimësinë e biznesit**

1. Subjekti kërkues ose titullari i licencës, sipas rastit, harton dhe dorëzon si pjesë e paketës së dokumenteve, politika dhe rregulla, në lidhje me vazhdimësinë e biznesit, të cilat duhet të përfshijnë

planin e vazhdimësisë së TIK-ut, menaxhimin e vazhdimësisë së shoqërisë, si dhe plane për rimëkëmbje ndaj katastrofave, të cilat duhet të sigurojnë ruajtjen e sigurt të të dhënave dhe funksioneve thelbësore, si dhe vijimin e ofrimit të shërbimeve në mënyrë të rregullt.

2. Planet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, duhet të mundësojnë rikuperimin e të dhënave dhe vijimin e ofrimit të shërbimit në një kohë të shpejtë.

#### Neni 28

##### **Qëndrueshmëria e sistemeve**

1. Subjekti kërkues ose titullari i licencës, sipas rastit, vendos dhe mirëmban sisteme dhe procedura të cilat sigurojnë që:

a) sistemet e tregtimit janë të qëndrueshme;

b) sistemet e tregtimit mbartin kapacitet të plotë për të përballuar pikun e flukseve të urdhrave dhe vëllimit të transaksioneve;

c) sistemet e tregtimit janë të afta për të garantuar tregtim të rregullt edhe në kushtet e luhatshmërisë së lartë të tregjeve;

ç) sistemi të refuzojë urdhra tregtimi të cilat tejkalojnë vëllimin dhe çmimin e paracaktuar ose, në rastet kur këto urdhra janë dukshëm të pasaktë, duke marrë parasysh madhësinë, natyrën dhe/ose faktorët të tjerë të brendshëm.

2. Në përmbushje të detyrimeve të këtij neni, titullari i licencës duhet të kryejë periodikisht teste stresi të sistemeve, në mënyrë që të sigurojë përputhshmërinë e tyre me kërkesat ligjore, si dhe të adresojë çdo parregullsi në përputhje me politikën e tij për vazhdimësinë e biznesit.

3. Titullari i licencës mund të kufizojë ose të pezullojë veprimtarinë e tij në rastet kur:

a) çmimi i ndonjërit prej tokenëve digjitalë/monedhave virtuale pëson një luhatshmëri të lartë në një periudhë të shkurtër kohore, duke përcaktuar në rregulloret e brendshme të tij edhe treguesit sasiorë që do të informojnë vendimin e bursës DLT për pezullim;

b) kushtet e jashtëzakonshme të tregut kanë ndikuar ose do të ndikojnë në mënyrë afatshkurtër edhe në veprimtarinë e bursës DLT.

4. Në raste përjashtimore, të cilat duhet të shprehen qartazi në faqen e internetit dhe në marrëveshjen ndërmjet klientëve dhe bursës DLT, titullari i licencës mund të anulojë, të amendojë ose



të saktësojë çdo transaksion ose shlyerje të ndodhur në platformë brenda 24 orëve nga kryerja e tij.

#### Neni 29

##### Marrëveshjet “White-Label”

1. Subjekti kërkuar ose titullari i licencës, sipas rastit, njofton autoritetet përgjegjëse për çdo marrëveshje “White-Label” që synon të nënshkruajë me palë të tjera, si dhe i vendos në dispozicion autoriteteve përgjegjëse të gjithë informacionin e nevojshëm për të mundësuar një shqyrtim tërësor të përputhshmërisë së kësaj veprimtarie me kërkesat ligjore në fuqi.

2. Nënshkrimi i një marrëveshjeje me një ofrues “White-Label” do të bëhet në përputhje me përcaktimet e nenit 18, të kësaj rregulloreje, në lidhje me delegimin e funksioneve dhe detyrave.

3. Implementimi i një marrëveshjeje “White-Label”, pavarësisht kushteve dhe termave të saj, në asnjë rast nuk e përjashton ose shkarkon nga përgjegjësia titullarin e licencës, i cili mbart përgjegjësinë e plotë për përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore të përcaktuara për bursat DLT.

#### Neni 30

##### Kujdestaria e aseteve

1. Në rastet kur titullari i licencës, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kryen shërbimin e kujdestarisë së tokenëve digjitalë/monedhave virtuale dhe/ose parave FIAT në emër dhe për llogari të klientëve, këto fonde ruhen në llogari të veçanta, të ndara veçmas, të cilat mund të jenë:

- a) llogari omnibus të klientëve;
- b) llogari individuale të klientëve.

2. Llogaritë e përmendura në pikën 1, të këtij neni, janë të ndara nga llogaritë ku ruhen fondet e titullarit të licencës dhe duhet të jenë plotësisht të veçuara gjatë gjithë kohës. Kjo ndarje dhe veçim i llogarive të klientëve të bursës DLT duhet të evidentohet edhe në marrëdhënien kontraktore midis titullarit të licencës dhe subjektit, i cili do të ruajë fondet, ku duhet të shprehet qartazi që llogaritë e klientëve të bursës DLT do të jenë të ndara veçmas dhe se subjekti në fjalë, si dhe çdo subjekt tjetër, në asnjë rast, nuk do të pretendojë dhe/ose tentojë të ekzekutojë asnjë lloj detyrimi, të

vendosin barrë sigurie ose çdo lloj kufizimi tjetër ndaj llogarive të klientëve të bursës DLT.

3. Në përputhje me nenin 56, të ligjit, titullari i licencës mund të caktojë një kujdestar të portofolit të palëve të treta, të licencuar, me qëllim ruajtjen e fondeve të klientëve të tij.

4. Titullari i licencës kryen një vlerësim të detajuar të kujdestarit të portofolit të palëve të treta, duke përfshirë eksperiencën, sistemet e përdorura dhe kontrollet e zbatueshme nga ky i fundit.

5. Titullari i licencës ndërmerr të gjitha masat për t’u siguruar se kujdestaria e aseteve nuk do të kryhet përmes ofruesve jokujdestarë të portofolit të palëve të treta, për sa kohë këto të fundit nuk operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

6. Në rastet kur titullari i licencës, në mënyrë direkte ose indirekte, implementon kujdestarinë e tokenëve digjitalë/monedhave virtuale përmes portofolave digjitale *offline*, ky i fundit duhet të sigurohet se “*hardware*-i” i përdorur për ruajtjen e fondeve të mbahet:

- a) nga një noter i licencuar, ose;
- b) në një kasë sigurie të bankave të nivelit të dytë ose institucioneve financiare jobankë.

#### Neni 31

##### Kapitali minimal

1. Në përputhje me nenet 57, 58 dhe 59, të ligjit, çdo bursë DLT duhet të vërtetojë se ka një kapital minimal prej:

a) 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh për bursën DLT të kategorisë “A”, në përputhje me nenin 57, të ligjit, duke vënë në dispozicion kopjen e dokumentit përkatës/garancinë e lëshuar në një nga bankat e nivelit të dytë që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) 60 000 000 (gjashtëdhjetë milionë) lekësh për bursën DLT të kategorisë “B” dhe se shuma e parave FIAT të depozituara në bursën DLT nuk duhet të tejkalojë në asnjë kohë vlerën totale prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh, në përputhje me nenin 58, të ligjit, duke vënë në dispozicion kopjen e dokumenteve përkatëse/provuese;

c) 90 000 000 (nëntëdhjetë milionë) lekësh për bursën DLT të kategorisë “C”, në përputhje me nenin 59, të ligjit, duke vënë në dispozicion kopjen e dokumentit përkatës/garancinë e lëshuar në një



nga bankat e nivelit të dytë që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Dokumentet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, vihen në dispozicion si dokumente provuese nëpërmjet një dokumenti bankar, që vërteton pagimin e kapitalit minimal në para, në një nga bankat e nivelit të dytë, që veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Dokumentet përkatëse duhet t'i bashkëlidhen kërkesës për aplikimin, e cila duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinale ose kopje të noterizuara, jo më të hershme se tre muaj nga data e aplikimit.

#### Neni 32

### Mjaftueshmëria e kapitalit

Bursa DLT duhet të sigurojë se ka mjaftueshëm fonde të veta për të mbuluar përgjegjësitë profesionale, në përputhje me përcaktimet e rregullores përkatëse, të nxjerrë nga autoriteti.

#### KREU III

### KËRKESAT PËR AFTËSI DHE PËRSHTATSHMËRI

#### Neni 33

### Personat që i nënshtrohen kërkesës për aftësi dhe përshtatshmëri

1. Administratori/ët, anëtari i këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit dhe personeli kyç i bursës DLT duhet të përmbushin kërkesat për aftësi dhe përshtatshmëri, si dhe të zotërojnë njohuritë e duhura teknike dhe ligjore, sipas përcaktimeve të nenit 9, të ligjit.

2. Personat e listuar në pikën 1, të këtij neni, depozitojnë informacionin dhe dokumentet e përcaktuara në nenin 34, të kësaj rregulloreje, sipas formularëve të shtojcës përkatëse.

3. Autoriteti, si pjesë e procesit të licencimit, vlerëson përmbushjen e kërkesave ligjore për aftësi dhe përshtatshmëri të zotëruesit/ve të pjesëmarrjes influencuese dhe personelit kyç të shoqërisë.

#### Neni 34

### Dokumentet për administratorin, anëtarin e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelin kyç

1. Bursa DLT ose subjekti kërkuar, sipas rastit, dorëzon pranë autoritetit dokumentet mbi administratorin, anëtarin e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe funksionarin në pozicionet e përcaktuara, si personel kyç, si më poshtë:

1.1 Dokumentet për administratorin, anëtarin e këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe funksionarin në pozicionet e përcaktuara si personel kyç, si më poshtë:

a) dokument identifikimi (ID/pasaportë);

b) *curriculum vitae*, ku të detajohet përvoja profesionale;

c) diploma, kualifikime, trajnime dhe dokumente të tjera me rëndësi që vërtetojnë arritjet akademike dhe profesionale;

ç) dokument i lëshuar nga administrata tatimore për gjendjen e detyrimeve tatimore;

d) vërtetim nga Regjistri i Kredive të Bankës së Shqipërisë për gjendjen e kredive në sistemin bankar.

1.2 Dokumente të lëshuara nga organet kompetente, si më poshtë:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore;

b) vërtetim nga prokuroria për hetim penal në proces;

c) vërtetim nga gjykata për çështje gjyqësore në proces;

ç) dokument lidhur me procese ekzekutimi të detyrueshëm apo për detyrime pasurore të pashlyera.

1.3 Deklaratë noteriale se:

a) nuk është përfshirë, nuk ka bashkëpunuar ose nuk është i lidhur me humbje financiare, të shkaktuara nga veprimet e pandershme, të papërgjegjshme apo neglizhente, në lidhje me kryerjen e shërbimeve financiare dhe administrimin e shoqërive të tjera; ose

b) nuk ka zotëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, të paktën 50% të të drejtave të votës apo të kapitalit të një shoqërie tregtare, ose nuk ka qenë administrator i një shoqërie tregtare, e cila është bërë objekt i procedurave të falimentimit, në zbatim të ligjit për falimentimin;



c) nuk është përfshirë në ndonjë praktikë tregtare, përfshirë edhe evazionin fiskal dhe pastrimin e parave, që autoriteti e konsideron të papërshtatshme, qoftë e ligjshme ose jo, e cila hedh dyshime për mënyrën e kryerjes së shërbimeve financiare apo të veprimtarive të tjera tregtare nga ky person.

1.4 Deklaratë noteriale për lidhje familjare ose marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi, sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë, sipas shtojcës përkatëse.

#### Neni 35

### Kërkesat për njohuritë e duhura teknike dhe ligjore

1. Administratori/ët, anëtari i këshillit mbikëqyrës /këshillit të administrimit dhe personeli kyç i bursës DLT ose subjektit kërkuar duhet të dëshmojnë aftësinë e tyre.

2. Për qëllime të pikës 1, të këtij neni, personat e sipërlistuar duhet të vërtetojnë, nëpërmjet dokumenteve provuese, se kanë përvojë profesionale të paktën 3 (tri) vite, duke ushtruar një nga veprimtaritë e mëposhtme:

a) veprimtari në fushën e së drejtës;

b) veprimtari në fushën e financave;

c) veprimtari në fushën e teknologjisë së informacionit, si zhvillues rrjeti (*web*), inxhinier DevOps, arkitekt i sistemit të informacionit/*cloud*, administrator rrjeti, zhvillues aplikacionesh, administrator baze të dhënash, zhvillues *Full Stack*, konsulent i sigurisë kibernetike, drejtues i strukturave të teknologjisë së informacionit etj.

3. Kryetari i këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit përmbush një nga kriteret e listuara në pikën 2, të këtij neni, për të paktën 5 (pesë) vite.

4. Personat e listuar në pikën 1, të këtij neni, duhet të zotërojnë një diplomë të nivelit “master” ose e barasvlershme, në fushën e drejtësisë dhe/ose ekonomisë, financave, teknologjisë së informacionit.

5. Dokumentet provuese për përmbushjen e kriterëve të listuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, janë:

a) kontrata punësimi ose kontrata për ofrimin e shërbimeve;

b) licencat përkatëse, nëse janë të aplikueshme;

c) librezë e punës, nëse është e aplikueshme;

ç) vërtetim për pagesën e kontributeve shoqërore;

d) diploma universitare brenda ose jashtë Shqipërisë.

6. Për qëllime të pikës 1, të këtij neni, personat e sipërlistuar duhet të vërtetojnë, nëpërmjet dokumenteve provuese, se kanë përvojë profesionale në:

a) të paktën 4 (katër) individë të certifikuar:

i. për kontrollin e sistemit të rrezikut dhe informacionit;

ii. si profesionistë të certifikuar të sigurisë në rene kompjuterike (CCSP);

iii. për zbatimin dhe menaxhimin e sistemeve të sigurisë së informacionit (CISM ose ekuivalentin e tij);

iv. si administratori i sigurisë nga prodhuesi (nga *Checkpoint*, *Fortinet*, *Cisco* ose ekuivalent);

b) të paktën nga një individ i certifikuar:

i. për *Certified Solutions Architect*;

ii. si zhvillues i certifikuar;

iii. për certifikimin në sigurinë e sistemit të informacionit (p.sh. OSCP ose SANS/GIAC GPE);

iv. si testues i depërimit, haker etik i certifikuar (CEH) ose akreditimi (p.sh. CREST);

v. si GIAC, trajtues i certifikuar i incidentit (GCIH).

7. Kriteret e listuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, përmbushen bashkërisht nga një ose më shumë persona të listuar në pikën 1, të këtij neni.

#### KREU IV

### AKTIVITETI TREGTAR NË BURSA DLT

#### Neni 36

### Listimi i tokenit digjital/monedhës virtuale në bursën DLT

1. Përpara listimit të një tokeni digjital/monedhe virtuale në bursën DLT, titullari i licencës duhet të sigurohet, përmes një analize të detajuar, se tokeni digjital/monedha virtuale është në përputhje me të gjitha kërkesat operationale të bursës DLT, si dhe legjislacionit në fuqi. Në zbatim të kësaj pike, titullari i licencës harton rregullore të brendshme për listimin e tokenëve digjitalë/monedhave virtuale, e cila, krahas kërkesave të përcaktuara në shkronjën “I”, të pikës 1, të nenit 53, të ligjit, duhet të përmbajë të paktën:



a) politikat, procedurat, tarifat e aplikueshme për pranimin e listimit të tokenit digjital/monedhës virtuale në bursën DLT;

b) kriteret për vlerësimin dhe klasifikimin e tokenit digjital, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto kriteret duhet të përmbajnë minimalisht informacione në lidhje me eksperiencën, reputacionin dhe historikun e të dhënave të emetuesit dhe stafit të tij;

c) kategoritë dhe llojet e tokenëve digjitalë / monedhave virtuale, të cilat nuk do të lejohen të listohen për t'u tregtuar në bursën DLT;

ç) llojet e kontrolleve që do të kryhen për të vlerësuar riskun, aspektet ekonomike dhe ato teknologjike të tokenit digjital/monedhës virtuale, përfshirë këtu emrat e personave që do të kryejnë këto kontrolle. Lista emërore e personave që do të kryejnë kontrollet, në zbatim të kësaj pike, firmoset nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë;

d) listën emërore të personave që do të kryejnë kontrollet, në zbatim shkronjës “ç”, të kësaj pike, të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë;

dh) rregulla dhe procedura për ndalimin e tregtimit të tokenëve digjitalë/monedhave virtuale të cilat përmbajnë funksione shtesë privatesie dhe anonimiteti që mundësojnë fshehjen e identitetit të përdoruesve dhe/ose historisë së transaksioneve me atë token digjital/monedhë virtuale;

e) rregulla dhe procedura për shqyrtimin mujor të cilësisë së tokenit digjital/monedhës virtuale. Këto rregulla duhet të përmbajnë të paktën:

i. të dhëna të përgjithshme mbi përdorueshmërinë e tokenit digjital/monedhës virtuale;

ii. informacion nëse tokeni digjital/monedha virtuale ka pasur çështje me autoritete rregullatore ose defekte teknike;

iii. informacion nëse ndonjë autoritet publik ose rregullator ka shprehur shqetësime mbi tokenin digjital/monedhën virtuale.

Neni 37

#### Aktiviteti tregtar

1. Titullari i licencës harton rregulla të brendshme për pjesëmarrjen e klientëve në veprimtarinë tregtare të bursës DLT, të cilat duhet të përmbajnë kriteret objektive, proporcionale që garantojnë akses të hapur në platformë.

2. Titullari i licencës harton procedura, si dhe vendos dhe mirëmban sisteme të përshtatshme të

cilat sigurojnë që klienti që vendos një urdhër tregtimi, ka mjaftueshëm asete në dispozicion për të mundësuar një shlyerje eficiente të transaksionit.

3. Titullari i licencës vendos dhe mirëmban sisteme të përshtatshme për të siguruar një verifikim të shpejtë dhe të saktë të urdhrave të tregtimit dhe përputhjen e tyre me instruksionet e shlyerjes.

4. Titullari i licencës duhet të publikojë kuota fikse për asetet që do të pranohen për tregtim ose një mënyrë përlogaritjeje të çmimit të asetit që synon të listojë për tregtim.

Neni 38

#### Transparenca

1. Titullari i licencës, gjatë orareve të tregtimit në platformë, duhet të publikojë në mënyrë të vazhdueshme ofertat, çmimet e përfitësuar, si dhe fluksin e kërkesës dhe ofertës për asetet që tregtohen në platformë.

2. Titullari i licencës duhet të publikojë në kohë reale llojin e aseteve, çmimin e tyre, vëllimin dhe kohën e transaksioneve të ekzekutuara për ato asete që tregtohen në platformë.

3. Informacioni i përcaktuar në këtë nen duhet të publikohet në faqen e internetit të titullarit të licencës, pa pagesë, për të paktën dy vjet.

Neni 39

#### Procedurat e shlyerjes

1. Titullari i licencës harton politika dhe rregulla të brendshme, në lidhje me:

a) konfirmimin e të dhënave të transaksionit;

b) kohën e caktuar se kur transaksioni do të konsiderohet përfundimtar;

c) masat që do të ndërmerren për të kufizuar numrin e shlyerjeve të dështuara;

ç) përcaktimin e afateve se kur transaksionet e pashlyera, udhëzimet për transferta dhe detyrime të tjera nuk mund të revokohen më nga ana e klientit.

2. Titullari i licencës vendos dhe mirëmban sisteme të përshtatshme për t'u siguruar kundrejt dështimit të proceseve të shlyerjes, si dhe vendos sisteme të përshtatshme, të cilat i trajtojnë këto defekte dhe monitorojnë dështimet e proceseve të shlyerjes së transaksioneve.

3. Në rastet kur procesi i shlyerjes nuk mund të përfundojë në kohë reale ose brenda ditës, titullari



i licencës duhet të sigurohet që ka ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për ta përmbysur shlyerjen jo më vonë se data e vlerës së transaksionit përkatës.

Neni 40

#### **Software-ët algoritmikë të tregtimit (Trading Bots)**

1. Në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në shkronjën “ç”, të nenit 51, të ligjit, titullari i licencës duhet të sigurohet se përdorimi i *trading bots* ose teknologjive të ngjashme nga ana e klientëve nuk do të rezultojë në hapjen e llogarive të shumëfishta nga ana e tyre.

2. Titullari i licencës harton politika dhe rregulla operacionale të cilat duhet të përmbajnë kriteret për përdorimin e *trading bots* nga ana e klientëve të bursës DLT. Kriteret për përdorimin e *trading bots*, ndër të tjera, duhet të përfshijnë dispozita të cilat sigurojnë që përdorimi i tyre nuk do të ketë pasoja në mirëfunksionimin e bursës dhe është në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e abuzimit me tregun.

Neni 41

#### **“Whitelisting” i klientëve dhe tokenëve digjitalë/monedhave virtuale**

1. Në përputhje me nenin 55 të ligjit, titullari i licencës harton politika dhe rregullore të brendshme për ‘whitelisting’ të:

a) klientëve të tij, përmes vendndodhjes së IP-së, shqyrtimit të adresës së postës elektronike ose referencave të tjera që do të arrijnë rezultate të përafërta;

b) tokenëve digjitalë/monedhave virtuale.

2. Gjatë hartimit të rregullave të brendshme dhe politikave për ‘whitelisting’ të tokenëve digjitalë/monedhave virtuale, titullari i licencës duhet të marrë masa për t’u siguruar se tokenët digjitalë/monedhat virtuale, të cilat mbartin elemente shtesë privatësie që mund të rrezikojnë përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, nuk do të listohen për tregim në bursën DLT.

Neni 42

#### **Qasja në bursën DLT**

1. Titullari i licencës sigurohet se autentifikimi i përdoruesve do të kryhet përmes dy faktorëve të ndryshëm.

2. Kodi unik i autentifikimit të klientit do të pranohet vetëm një herë, nga ana e titullarit të licencës, për t’i mundësuar klientëve të tij qasje në llogaritë e tyre *online*, kryerjen e transaksioneve të caktuara ose të ndërmarrin veprime përmes kanaleve në distancë, të cilat mund të paraqesin rreziqe në lidhje me mashtrimin dhe/ose abuzime të tjera.

KREU V

#### **PËRPUTHSHMËRIA E BURSËS DLT NË VIJIMËSI**

Neni 43

#### **Dispozita të përgjithshme**

1. Bursa DLT emëron një nga anëtarët e personelit kyç si zyrtar të përputhshmërisë. Funkcioni i zyrtarit të përputhshmërisë duhet të jetë i pavarur nga çdo funksion tjetër brenda shoqërisë, përveç atij ZPPPPFT dhe menaxherit të riskut.

2. Zyrtari i përputhshmërisë raporton pranë këshillit mbikëqyrës, të paktën në baza tremujore, te bordi i drejtorëve ose këshilli mbikëqyrës, sipas rastit.

Neni 44

#### **Programi i monitorimit të përputhshmërisë**

1. Titullari i licencës vendos dhe mirëmban një program të monitorimit të përputhshmërisë, i cili përmban funksionet e mëposhtme:

a) monitorimin në mënyrë të vazhdueshme të të gjithë veprimtarisë së shoqërisë, bazuar në një plan monitorimi të përputhshmërisë. Plani i monitorimit të përputhshmërisë duhet të evidentohet si seksion i veçantë në brendësi të një manuali të dedikuar për procedurat e sigurimit të përputhshmërisë;

b) vlerësimin, bazuar në monitorimin e veprimtarive të përmendura më lart, të përputhshmërisë dhe efektivitetit të masave dhe procedurave të vendosura nga shoqëria me legjislacionin në fuqi;



c) ruajtjen dhe regjistrimin e veprimeve të ndërmarra, në mënyrë që të sigurohet respektimi i detyrimeve të sipërpërmendura;

ç) këshillimin dhe ofrimin e asistencës ndaj strukturave drejtuese të shoqërisë në sigurimin e përputhshmërisë së bursës DLT me detyrimet e kuadrit ligjor në fuqi.

2. Për të siguruar përputhshmërinë me dispozitat e këtij neni:

a) funksioni i përputhshmërisë duhet të ketë autoritetin, burimet, ekspertizën dhe qasjen e nevojshme në të gjithë informacionin përkatës;

b) zyrtari i përputhshmërisë do të emërohet dhe do të jetë përgjegjës për funksionin e përputhshmërisë dhe për çdo raportim, në lidhje me përputhshmërinë, të përcaktuara sipas kësaj rregulloreje dhe ligjit;

c) personat përkatës të përfshirë në funksionin e përputhshmërisë nuk do të përfshihen në kryerjen e shërbimeve ose aktiviteteve që ata monitorojnë, por mund të emërohen si ZPPPPFT dhe/ose si menaxher i riskut.

3. Pavarësisht përcaktimeve të këtij neni, përgjegjësia fundore për përputhshmërinë e bursës DLT me kuadrin ligjor në fuqi i ngarkohet këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës të shoqërisë.

#### Neni 45

##### Auditi i brendshëm

1. Titullari i licencës ose subjekti kërkues, sipas rastit, emëron një person si auditues i brendshëm, funksion i cili duhet të jetë i pavarur nga funksione të tjera të shoqërisë. Funksionet e audituesit të brendshëm mund të kryhen nga persona brenda strukturës së shoqërisë, sipas rastit, ose mund të nënkontraktohen të shoqëri të cilat zotërojnë ekspertizën e duhur për të ushtruar këtë veprimtari.

2. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, audituesi i brendshëm duhet të përmbushë funksionet e mëposhtme:

a) të krijojë dhe të zbatojë një plan auditimi për të shqyrtuar mekanizmat e sistemet e auditimit të brendshëm;

b) të japë rekomandime bazuar në rezultatin e punës së kryer, në përputhje me shkronjën “a” të kësaj pike;

c) të verifikojë pajtueshmërinë me ato rekomandime; dhe

ç) t'i raportojë, në lidhje me çështjet e auditimit të brendshëm, bordit drejtues, këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit dhe personave të tjerë në nivele të larta drejtuese.

3. Titullari i licencës mund të kërkojë përjashtimin nga detyrimi i përcaktuar në këtë nen me anë të një kërkesë drejtuar Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

4. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare shqyrton, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, kërkesën, duke marrë në konsideratë madhësinë, strukturën, kompleksitetin dhe mënyrën e organizimit të shoqërisë së bursës DLT.

5. Nëse nuk konfirmohet ndryshe me shkrim nga autoriteti, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, çdo kërkesë, sipas pikës 3, të këtij neni, do të konsiderohet e refuzuar.

#### Neni 46

##### Përgjegjësia e bursës DLT

1. Krahas parashikimeve të nenit 54, të ligjit, bursa DLT mban përgjegjësi për dëmet e shkaktuara kundrejt palëve të treta, përveç rasteve kur bursa DLT mund të vërtetojë, përmes një ekspertize të pavarur, se ka ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për të parandaluar ndodhinë që ka rezultuar në dëme kundrejt palëve të treta.

2. Titullari i licencës ndërmerr të gjitha masat që dokumentacioni/informacioni i kërkuar të vihet në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse në kohën e duhur.

#### Neni 47

##### Detyrimet për publikim

Krahas detyrimeve për publikim, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, titullarët e licencës mbartin detyrimin të publikojnë në faqen e tyre të internetit informacionin e mëposhtëm:

a) të dhënat e kontaktit, përfshirë këtu adresën e selisë qendrore të titullarit të licencës;

b) statusin e tyre rregullator;

c) të gjitha tarifat e aplikueshme për ofrimin e shërbimeve. Titullari i licencës duhet të sigurohet se struktura e tarifave të vendosura është transparente, e drejtë, jodiskriminuese dhe nuk incentivon vendosjen, modifikimin ose anulimin e urdhrave të tregtimit ose ekzekutimin e transaksioneve të cilat



kontribuojnë në krijimin e kushteve për tregtim të rregullt dhe/ose abuzim me tregun.

## KREU VI MIRATIMI I NDRYSHIMEVE

Neni 48

### Ndryshimet që kërkojnë miratim

Autoriteti miraton paraprakisht çdo veprim të bursës DLT, në lidhje me:

- a) ndryshimin e emrit ose objektin e veprimtarisë së bursës DLT;
- b) ofrimin në mënyrë direkte ose indirekte të shërbimeve të saj jashtë Republikës së Shqipërisë, duke krijuar një shoqëri të re në vendin përkatës ose duke i ofruar shërbimet e saj nga Republika e Shqipërisë;
- c) ndryshimin e kapitalit të saj ose të drejtat e aksionarëve të shoqërisë;
- ç) ndryshimin e zotëruesve të pjesëmarrjes influencuese;
- d) emërimin, zëvendësimin e administratorit, anëtarëve të këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit dhe personelit kyç, duke përfshirë ZPPPPFT-në.

Neni 49

### Kërkesa dhe dokumentet për ndryshimin e veprimtarisë tregtare

1. Bursa DLT njofton paraprakisht autoritetin për ndryshime në:

- a) veprimtarinë tregtare dhe mënyrën e ushtrimit të saj;
- b) ndërprerjen e kryerjes së një ose më shumë shërbimeve për të cilat është licencuar;
- c) bazën e synuar të klientëve.

2. Njoftimi për ndryshimet e mësipërme shoqërohet me kërkesën sipas shtojcës përkatëse, si dhe dokumentet e përditësuara, të përcaktuara në nenin 12, të kësaj rregulloreje, për të vërtetuar përshtatjen me ndryshimet e kërkuara.

Neni 50

### Kërkesa dhe dokumentet për ofrimin e shërbimeve jashtë Republikës së Shqipërisë

1. Bursa DLT mund të ofrojë shërbimet e saj jashtë Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet

vendosjes së një dege ose duke i ofruar ato nga Republika e Shqipërisë, me kusht që shërbimet dhe veprimtaritë që propozon të ofrojë jashtë Republikës së Shqipërisë të përfshihen në një licencë të dhënë nga autoriteti.

2. Bursa DLT, që kërkon të ofrojë shërbimet e saj nga Republika e Shqipërisë për klientë që ndodhen jashtë saj ose të regjistrojë një degë jashtë Republikës së Shqipërisë, njofton paraprakisht autoritetin dhe i vendos në dispozicion informacionet e mëposhtme:

- a) juridiksionin ku kërkon të ofrojë shërbimet;
- b) një analizë ligjore të hartuar nga agjenti TD, që konfirmon se kuadri ligjor i juridiksionit përkatës lejon ofrimin e këtyre shërbimeve nga ana e bursës DLT;
- c) programin e veprimtarive, ku përshkruhen, ndër të tjera, shërbimet që propozon të ofrojë në vendin e huaj;
- ç) planin e detajuar të marketingut;
- d) strukturën organizative të degës, në rastet kur kërkohet të regjistrohet një degë jashtë Republikës së Shqipërisë;
- dh) adresën në vendin e huaj nga e cila mund të merren dokumente, në rastet kur kërkohet të regjistrohet një degë jashtë Republikës së Shqipërisë;
- e) emrat e personave, të cilët janë përgjegjës për administrimin e degës, në rastet kur kërkohet të regjistrohet një degë jashtë Republikës së Shqipërisë;
- ë) konfirmimin nga autoriteti i huaj rregullator se bursa DLT mund të kryejë veprimtaritë e propozuara në vendin e huaj.

Neni 51

### Kërkesa dhe dokumentet për ndryshime të zotëruesve të pjesëmarrjes influencuese

1. Personi fizik ose juridik që kërkon të zotërojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, pjesëmarrje influencuese ose kërkon të rrisë, të shesë ose të zvogëlojë zotërimin e pjesëmarrjes influencuese në shoqërinë e bursës DLT, njofton paraprakisht me shkrim autoritetin për qëllimin e tij.

2. Individët, që kërkojnë të bëhen zotërues të pjesëmarrjes influencuese, duhet të depozitojnë kërkesë sipas shtojcës përkatëse dhe dokumentacionin përkatës, të përcaktuar në nenin 14, të kësaj rregulloreje.



3. Autoriteti, në rastet e ndryshimit të zotëruesve të pjesëmarrjes influencuese, vlerëson përshtatshmërinë e blerësit të propozuar, duke marrë në konsideratë edhe kriteret, si më poshtë:

a) blerësi i propozuar të jetë i aftë dhe i përshtatshëm për këtë qëllim në përputhje me kërkesat e ligjit dhe kësaj rregulloreje;

b) ndryshimi i pjesëmarrjes nuk rrezikon interesat e klientëve.

Neni 52

**Kërkesa dhe dokumentet për ndryshimin e administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç**

1. Bursa DLT duhet të njoftojë paraprakisht autoritetin për çdo ndryshim të administratorit, anëtarëve të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç.

2. Për çdo person që do të emërohet si administrator, anëtar i këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës, shoqëria duhet të depozitojë kërkesë sipas shtojcës përkatëse, si dhe dokumentacionin e përcaktuar në nenin 14, të kësaj rregulloreje.

3. Për çdo person që emërohet në funksione brenda shoqërisë, të përcaktuara për personelin kyç, shoqëria duhet të depozitojë kërkesë sipas shtojcës përkatëse, si dhe dokumentacionin e përcaktuar në nenin 34, të kësaj rregulloreje.

4. Njoftimi dhe dokumentacioni përkatës depozitohen në autoritet 3 (tre) muaj para bërjes efektive të ndryshimeve.

Neni 53

**Riemërimi i administratorit, anëtarit të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç të bursës DLT**

1. Bursa DLT njofton autoritetin brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e vendimit, por jo më vonë se përfundimi i mandatit, për riemërimin e administratorit/anëtarit të këshillit të administrimit / këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç.

2. Për çdo ndryshim të të dhënave, mbi bazën e të cilave është vlerësuar dhe miratuar administratori, anëtari i këshillit të administrimit / këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç, bursa DLT

njofton me shkrim autoritetin, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga ndryshimi i këtyre të dhënave.

3. Për çdo person që do të riemërohet si administrator, anëtar i këshillit të administrimit / këshillit mbikëqyrës ose personel kyç, bursa DLT duhet të depozitojë vendimin e organit kompetent për riemërimin, shoqëruar me një CV të përditësuar sipas formatit të përcaktuar në shtojcën përkatëse.

Neni 54

**Procedura për miratimin e ndryshimeve**

1. Autoriteti shqyrton kërkesën dhe dokumentet shoqëruese dhe merr vendim, në lidhje me miratimin ose jo të ndryshimeve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës.

2. Mënyra e shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve dhe vlerësimi i tyre kryhen në përputhje me dispozitat e nenit 7, të kësaj rregulloreje.

**KREU VII**

**RAPORTIMI NË AUTORITET**

Neni 55

**Detyrimet për raportim**

1. Bursa DLT njofton me shkrim autoritetin, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve pune nga ndodhitë/ngjarjet e mëposhtme, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë nen:

a) ndryshimi i adresës dhe çdo ndryshim i të dhënave të kontaktit, menjëherë pas bërjes efektive të këtyre ndryshimeve;

b) çdo propozim në lidhje me ndryshime thelbësore në shoqëri, të paktën një muaj përpara se ndryshimi i propozuar të hyjë në fuqi;

c) vënia në dijeni për çdo indicie ose provë që vërteton ose ndihmon të vërtetojë kryerjen e mashtrimit ose veprimeve të pandershme të punonjësve dhe/ose klientëve të tij, menjëherë nga momenti i vënies në dijeni të tij;

ç) marrja e vendimit për të bërë një kërkesë për dëshmipërbllim në kuadër të sigurimit profesional, garancisë bankare ose në kuadër të ndonjë police tjetër sigurimi mbi biznesin e bursës DLT. Njoftimi në autoritet duhet të bëhet para se të merret njoftimi i vendimit përkatës për palën tjetër të bursës DLT, në mënyrë që çdo koment i dhënë



nga autoriteti të merret parasysh përpara zbatimit të këtij vendimi;

d) përfshirjen e bursës DLT ose personelit kyç të saj si palë ndërgjyqëse, menjëherë pas marrjes së njoftimit në lidhje me këto procese gjyqësore;

dh) çdo ndryshim në dokumentet dhe/ose informacionin e depozituar pranë autoritetit, menjëherë pas vënies në dijeni;

e) çdo informacion tjetër thelbësor, në lidhje me veprimtarinë e bursës DLT, funksionarët e tij, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë;

ë) çdo shkelje të kërkesave për licencim për bursën DLT, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, menjëherë sapo vendoset në dijeni për shkeljet;

f) çdo shkelje të kërkesave për licencim, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi nga ana e klientëve të bursës DLT, menjëherë sapo ky i fundit vendoset në dijeni për shkeljen;

g) çdo shkelje të detyrimeve për ofruesit e shërbimeve të mjeteve virtuale, si dhe çdo shkelje tjetër të legjislacionit në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

2. Pavarësisht nga sa më sipër, autoriteti mund të vendosë, me anë të njoftimeve të mëtejshme, të kërkojë herë pas here informacion shtesë, për të siguruar që ofrimi i shërbimeve nga bursa DLT të kryhet në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi.

#### Neni 56

#### Deklarata e përputhshmërisë

1. Në përputhje me nenin 17, të ligjit, brenda muajit të dymbëdhjetë nga data e marrjes së licencës dhe brenda muajit janar të çdo viti të mëpasshëm, titullari i licencës, përmes agentit TD, duhet të hartojë dhe të dorëzojë pranë autoritetit deklaratën e përputhshmërisë, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën përkatëse, përmes së cilës garantohet përputhshmëria ligjore e veprimtarisë së tij. Deklaratës së përputhshmërisë duhet t'i bashkëlidhen të paktën:

a) dokumente që vërtetojnë mbajtjen në vazhdimësi të nivelit të kërkuar kapitalit rregullator;

b) dokumente në lidhje me ndryshime në strukturën menaxhuese të bursës DLT, ku përfshihen ndryshimet e administratorit, anëtarëve të këshillit të administrimit/këshillit mbikëqyrës dhe personelit kyç;

c) politikat dhe rregullat e brendshme të funksionimit, të përditësuara;

ç) pasqyrat financiare vjetore të audituara në përputhje me legjislacionin në fuqi, së bashku me një kopje të raportit të auditimit.

2. Autoriteti shqyrton deklaratën e përputhshmërisë dhe dokumentet sipas pikës 1, të këtij neni, brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune nga marrja në dorëzim e tyre.

3. Autoriteti rezervon të drejtën për të kërkuar informacione ose dokumente shtesë, të cilat vihen në dispozicion nga kujdestari i portofolit të palëve të treta jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga data e paraqitjes së kërkesës nga autoriteti. Në këtë rast, afati 30 (tridhjetë)-ditor i përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, pezullohet deri në momentin e dorëzimit të plotë të informacionit dhe/ose dokumenteve të kërkuara. Në çdo rast, afati i përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, nuk paragjykon të drejtën e autoritetit për të kërkuar në çdo kohë informacion ose dokumente shtesë, në lidhje me veprimtarinë e agentit TD dhe/ose titullarëve të licencës për të cilët vepron në emër dhe për llogari, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

4. Në rast të konstatimit të mospërputhshmërisë së bursës DLT me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe/ose legjislacionit në fuqi, autoriteti ndërmerr masat administrative të parashikuara në nenin 19, të seksionit V, të kreut II, dhe në kreun XI, të ligjit.

#### Neni 57

#### Auditimi

Bursa DLT dorëzon pasqyrat financiare vjetore të audituara, të përgatitura në përputhje me standardet e kontabilitetit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

### KREU VIII DISPOZITA TË FUNDIT

#### Neni 58

#### Shtojcat

Autoritetet përgjegjëse ngarkohen që të miratojnë me urdhër të përbashkët modelet e shtojcave të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 59  
Të fundit

Aplikuesit për licencë burse DLT, përveç parashikimeve të kësaj rregulloreje dhe parashikimeve të ligjit, janë të detyruar të përmbushin dhe çdo kërkesë tjetër që mund të vijë si parashikim i rregulloreve të veçanta të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

VENDIM  
Nr. 710, datë 24.11.2021**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA  
NË VENDIMIN NR. 285, DATË 19.5.2021,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR  
MIRATIMIN E RREGULLAVE TË  
PROKURIMIT PUBLIK”<sup>1</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, pika 2, 13, pika 1, shkronja “a”, 14, pika 3, 17, pikat 1 dhe 2, 21, pika 4, 23, shkronjat “c” dhe “g”, 33, pika 2, 34, pika 2, 35, pika 3, 41, pika 2, 42, pikat 1 dhe 3, shkronja “a”, 43, pikat 1 dhe 4, shkronja “a”, 44, pika 1, 50, pikat 2 dhe 7, 54, pika 1, 56, pika 4, 57, pikat 1 dhe 2, shkronja “c”, 58, pika 2, 71, pikat 1 dhe 2, shkronja “c”, 72, pika 1, 74, pika 1, 78, pika 3, 82, pikat 1 dhe 5, 111, pika 1, 116, pika 4, 124, pika 6, 131, pika 2, e 132, pika 2, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

<sup>1</sup> Ky vendim është përafshuar pjesërisht me:

- Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Mbi prokurimin publik dhe që shfuqizon direktivën 2014/18/KE”, të ndryshuar”, me numër CELEX 32014L0024, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, faqe 65–242;

- Direktivën 2014/25/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin nga entitete që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon direktivën 2004/17/KE”, të ndryshuar”, me numër CELEX 32014L0025, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, numër 94, datë 28.3.2014, faqe 243–374.

## VENDOSI:

Në tekstin bashkëlidhur vendimit nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në nenin 26, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën “dh”, të pikës 2, fjalët “... për pagimin e tatimeve ...” zëvendësohen me “... për pagimin e taksave dhe tatimeve ...”.

b) Në paragrafin e parë, të pikës 6, fjalia e parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h” “i”, “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”.

2. Në pikën 3, të nenit 30, “Sigurimi i ofertës”, në fund të fjalisë së parë shtohen fjalët “... të kontratës ose lotit ...”.

3. Në nenin 38, “Njoftimi i anulimit”, pikat 1 e 3, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Autoriteti/enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 (tri) ditë nga marrja e vendimit.

...

3. Autoriteti/enti kontraktor vijon me publikimin e vendimit përfundimtar për anulimin e procedurës së prokurimit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin, duke e publikuar njoftimin në të njëjtën mënyrë siç publikon njoftimin e kontratës.”.

4. Në nenin 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1 hiqen fjalët “... dhe, sipas rastit, të xhiros që mbulon kontrata.”.

b) Kudo në përmbajtje të pikës 2, fjalët “... vlerës së parashikuar të kontratës ...” zëvendësohen me “... vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit ...”.



c) Në pikën 4 fjalja e dytë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivit.”.

5. Në nenin 45, “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pas pikës 2 shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomiksht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet, bazuar në:

a) çmimin e bursës, livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftime Publike;

b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.”.

6. Në nenin 48, “Procedura e kufizuar”, pika 2, shfuqizohet.

7. Në nenin 54, “Shërbim konsulence”, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Pas mbylljes së fazës së kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur për paraqitjen e propozimeve.”.

b) Shkronja “e”, e pikës 11, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“e) Në vijim, autoriteti/enti kontraktor identifikon ofertën më të mirë dhe shpall ofertuesin fitues. Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor fton ofertuesin fitues për të nënshkruar kontratën.”.

8. Në nenin 55, “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, në shkronjën “a”, të paragrafit të tretë, të pikës 4, fjalët “... vlerës së përlllogaritur të kontratës ...” dhe “... vlera limit e kontratës ...” zëvendësohen, përkatësisht, me “... vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit ...” dhe “... vlera limit e kontratës ose lotit ...”.

9. Në nenin 62, “Rregulla për prokurimin e marrëveshjes kuadër”, në pikën 5, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Kur, autoriteti/enti kontraktor vendos vlerësimin e ofertave mbi bazën e “çmim për

njësi”, përveç vlerës së pritshme të kontratave përlllogarit edhe shumatoren e çmimeve për njësi për çdo artikull apo shërbim, e cila publikohet bashkë me vlerën e pritshme të kontratave në njoftimin e kontratës. Në këtë rast, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Për efekt krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi, të përlllogaritur për çdo artikull apo shërbim nga autoriteti/enti kontraktor.”.

10. Në nenin 67, “Prokurimi i përqendruar dhe delegimi i prokurimit”, në pikën 2, shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Me kërkesë të një autoriteti ose enti kontraktor ose me nismën e vet, Këshilli i Ministrave, sipas pikës 2, të nenit 53, të LPP-së, mund të ngarkojë për procedura të veçanta prokurimi një autoritet ose ent tjetër kontraktor si organ qendror blerës.”.

11. Në fund të pikës 9, të nenit 68, “Sistemi dinamik i blerjes”, shtohen fjalët “..., për të cilin nuk zbatohen parashikimet e nenit 116, të LPP-së, për ankimin administrativ.”.

12. Në nenin 107, “Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës”, pas pikës 8 shtohen pikat 9 dhe 10, me këtë përmbajtje:

“9. Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e normës së fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet/entet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, livruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment.

10. Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit duhet të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave livruar, sipas kushtit CIF-Shqipëri, në momentin e shitjes së mallit, objekt kontrate, autoriteteve kontraktore, si dhe cilësinë e mallit



të livruar, nëse është e njëjtë me atë për të cilën është shpallur fitues kontraktori.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Arben Ahmetaj

**VENDIM**  
Nr. 712, datë 24.11.2021

### PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Albert Nikolla, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Arben Ahmetaj

**VENDIM**  
Nr. 713, datë 24.11.2021

### PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Vjollca Braho emërohet zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Arben Ahmetaj

### VENDIM

Nr. 714, datë 24.11.2021

### PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE “HALIT COKA”, BASHKIA KAMZË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “Halit Coka”, Bashkia Kamzë, në masën 444 000 000 (katërqind e dyzet e katër milionë) lekë pa TVSH.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2021, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “Halit Coka”, Bashkia Kamzë, në masën 88 800 000 (tetëdhjetë e tetë milionë e tetëqind mijë) lekë pa TVSH, i cili do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecure të ngadaltë.

3. Caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “Halit Coka”, Bashkia Kamzë, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Arben Ahmetaj

**VENDIM****Nr. 715, datë 24.11.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË  
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E  
RIKONSTRUKSIONIT E TË RIPARIMIT  
TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI  
OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA  
(PALLAT), NË BASHKITË TIRANË,  
DURRËS DHE MIRDITË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 824 836 517 (tetëqind e njëzet e katër milionë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Mirditë, sipas detajimit të mëposhtëm:

- a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi, në masën 240 000 000 (dyqind e dyzet milionë) lekë;
- b) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 388 182 835 (treqind e tetëdhjetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tridhjetë e pesë) lekë;
- c) Bashkisë Mirditë i transferohet fondi, në masën 196 653 682 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy) lekë.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2021, në masën 164 967 303 lekë (njëqind e gjashtëdhjetë e katër milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tre) lekë, për financimin e rikonstruksionit ose të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në

ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Mirditë, sipas detajimit të mëposhtëm:

- a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi, në masën 48 000 000 (dyzet e tetë milionë) lekë;
- b) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 77 636 567 (shtatëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë;
- c) Bashkisë Mirditë i transferohet fondi, në masën 39 330 736 (tridhjetë e nëntë milionë e treqind e tridhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

3. Efekti financiar, për vitin 2021, të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe t’u transferohet bashkive Tiranë, Durrës dhe Mirditë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Tiranë, Durrës dhe Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Arben Ahmetaj**

**VENDIM****Nr. 716, datë 24.11.2021**

**PËR KALIMIN TE BASHKITË TIRANË  
DHE SHIJAK TË NJËSIVE  
INDIVIDUALE TË BANIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin te bashkitë Tiranë dhe Shijak, përkatësisht, të 20 njësive individuale të banimit në Njësinë Administrative Vaqar, Bashkia Tiranë, dhe 25 njësive individuale të banimit, Bashkia Shijak,



sipas listës së inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkitë Tiranë e Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Arben Ahmetaj

Listë inventari - 25 Banesa individuale

| NR. | ID. | Emër Mbiemër             | Tipologjia | Sip. (m <sup>2</sup> ) | Bashkia | Njësia Admin. | Vlera e objektit [LEKË] | Vlera e mbikëqyrjes [LEKË] | Vlera e kolaudit [LEKË] |
|-----|-----|--------------------------|------------|------------------------|---------|---------------|-------------------------|----------------------------|-------------------------|
| 1   | 317 | Ermir Shpetim Deliallisi | 2+1        | 80                     | Shijak  | Shijak        | 2,470,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 2   | 331 | Vathe Rexhep Keci        | 2+1        | 80                     | Shijak  | Shijak        | 2,470,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 3   | 397 | Marsida Baki Tahiri      | 2+1        | 80                     | Shijak  | Shijak        | 2,470,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 4   | 379 | Shaban SALI Çalliku      | 3+1        | 105.1                  | Shijak  | Shijak        | 3,090,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 5   | 426 | Ramie SHABAN Ademi       | 2+1        | 80                     | Shijak  | Shijak        | 2,470,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 6   | 455 | Shyqyri SHABAN Shahini   | 2+1        | 80                     | Shijak  | Gjepalaj      | 2,470,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 7   | 467 | Hidajete IBRAHIM Elezi   | 1+1        | 70                     | Shijak  | Gjepalaj      | 2,095,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 8   | 475 | Ismet MUSA Shehi         | 2+1        | 80                     | Shijak  | Gjepalaj      | 2,470,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 9   | 477 | Besjana FLAMUR Kokomani  | 1+1        | 70                     | Shijak  | Gjepalaj      | 2,095,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 10  | 479 | Ismail QAMIL Baftjari    | 3+1        | 105.1                  | Shijak  | Gjepalaj      | 3,090,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 11  | 478 | Sanije XHEMAL Koçi       | 1+1        | 70                     | Shijak  | Gjepalaj      | 2,095,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 12  | 504 | Musa BAF'IIAR Çali       | 1+1        | 70                     | Shijak  | Gjepalaj      | 2,095,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 13  | 556 | Ndriçim HARIZ Çalliku    | 3+1        | 105.1                  | Shijak  | Gjepalaj      | 3,090,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 14  | 567 | Lumturie SHEFQET Çalliku | 1+1        | 70                     | Shijak  | Gjepalaj      | 2,095,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 15  | 343 | Rifat ZYDI Tepshi        | 2+1        | 80                     | Shijak  | Shijak        | 2,470,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 16  | 347 | Syrja ZENEL Arrasi       | 1+1        | 70                     | Shijak  | Shijak        | 2,095,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 17  | 356 | Refat HASAN Çeka         | 2+1        | 80                     | Shijak  | Shijak        | 2,470,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 18  | 366 | Safet HAJDAR Gjepali     | 3+1        | 105.1                  | Shijak  | Shijak        | 3,090,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 19  | 425 | Tahsim SHABAN Keçi       | 2+1        | 80                     | Shijak  | Shijak        | 2,470,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 20  | 438 | Robert ALLAN Tahiri      | 3+1        | 105.1                  | Shijak  | Shijak        | 3,090,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 21  | 476 | Murat RYSTEM Vreto       | 2+1        | 80                     | Shijak  | Gjepalaj      | 2,470,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 22  | 540 | Xhire MUSA Reka          | 3+1        | 105.1                  | Shijak  | Gjepalaj      | 3,090,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 23  | 563 | Qamil HASAN Toçi         | 3+1        | 105.1                  | Shijak  | Gjepalaj      | 3,090,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 24  | 597 | Denis Shahini            | 2+1        | 80                     | Shijak  | Gjepalaj      | 2,470,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |
| 25  | 614 | Ardian Tahir Telha       | 3+1        | 105.1                  | Shijak  | Gjepalaj      | 3,090,000               | 17,395.90                  | 1,897.80                |

| Nr. | Emër Mbiemër      | Tipologjia | Sip. (m <sup>2</sup> ) | Bashkia | Njësia Administrative | Vlera e objektit (lekë) | Vlera e mbikëqyrjes (lekë) | Vlera e kolaudit (lekë) | Vlera e mobilimit (lekë) |
|-----|-------------------|------------|------------------------|---------|-----------------------|-------------------------|----------------------------|-------------------------|--------------------------|
| 1   | Subjekt përfitues | 1+1        | 70                     | Tiranë  | Vaqar                 | 2,432,000.00            | 17,395.90                  | 1,897.80                | 400,000.00               |
| 2   | Subjekt përfitues | 1+1        | 70                     | Tiranë  | Vaqar                 | 2,432,000.00            | 17,395.90                  | 1,897.80                | 400,000.00               |
| 3   | Subjekt përfitues | 1+1        | 70                     | Tiranë  | Vaqar                 | 2,432,000.00            | 17,395.90                  | 1,897.80                | 400,000.00               |
| 4   | Subjekt përfitues | 1+1        | 70                     | Tiranë  | Vaqar                 | 2,432,000.00            | 17,395.90                  | 1,897.80                | 400,000.00               |
| 5   | Subjekt përfitues | 1+1        | 70                     | Tiranë  | Vaqar                 | 2,432,000.00            | 17,395.90                  | 1,897.80                | 400,000.00               |
| 6   | Subjekt përfitues | 1+1        | 70                     | Tiranë  | Vaqar                 | 2,432,000.00            | 17,395.90                  | 1,897.80                | 400,000.00               |
| 7   | Subjekt përfitues | 1+1        | 70                     | Tiranë  | Vaqar                 | 2,432,000.00            | 17,395.90                  | 1,897.80                | 400,000.00               |
| 8   | Subjekt përfitues | 1+1        | 70                     | Tiranë  | Vaqar                 | 2,432,000.00            | 17,395.90                  | 1,897.80                | 400,000.00               |
| 9   | Subjekt përfitues | 1+1        | 70                     | Tiranë  | Vaqar                 | 2,432,000.00            | 17,395.90                  | 1,897.80                | 400,000.00               |



|    |                   |     |       |        |       |              |           |          |            |
|----|-------------------|-----|-------|--------|-------|--------------|-----------|----------|------------|
| 10 | Subjekt përfitues | 2+1 | 80    | Tiranë | Vaqar | 2,606,400.00 | 17,395.90 | 1,897.80 | 450,000.00 |
| 11 | Subjekt përfitues | 2+1 | 80    | Tiranë | Vaqar | 2,606,400.00 | 17,395.90 | 1,897.80 | 450,000.00 |
| 12 | Subjekt përfitues | 2+1 | 80    | Tiranë | Vaqar | 2,606,400.00 | 17,395.90 | 1,897.80 | 450,000.00 |
| 13 | Subjekt përfitues | 2+1 | 80    | Tiranë | Vaqar | 2,606,400.00 | 17,395.90 | 1,897.80 | 450,000.00 |
| 14 | Subjekt përfitues | 2+1 | 80    | Tiranë | Vaqar | 2,606,400.00 | 17,395.90 | 1,897.80 | 450,000.00 |
| 15 | Subjekt përfitues | 2+1 | 80    | Tiranë | Vaqar | 2,606,400.00 | 17,395.90 | 1,897.80 | 450,000.00 |
| 16 | Subjekt përfitues | 3+1 | 105.1 | Tiranë | Vaqar | 3,200,200.00 | 17,395.90 | 1,897.80 | 530,000.00 |
| 17 | Subjekt përfitues | 3+1 | 105.1 | Tiranë | Vaqar | 3,200,200.00 | 17,395.90 | 1,897.80 | 530,000.00 |
| 18 | Subjekt përfitues | 3+1 | 105.1 | Tiranë | Vaqar | 3,200,200.00 | 17,395.90 | 1,897.80 | 530,000.00 |
| 19 | Subjekt përfitues | 3+1 | 105.1 | Tiranë | Vaqar | 3,200,200.00 | 17,395.90 | 1,897.80 | 530,000.00 |
| 20 | Subjekt përfitues | 3+1 | 105.1 | Tiranë | Vaqar | 3,200,200.00 | 17,395.90 | 1,897.80 | 530,000.00 |

**VENDIM****Nr. 717, datë 24.11.2021**

**PËR MIRATIMIN E  
MEMORANDUMIT TË MARRËVESHJES  
NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA  
DREJTORIA E SHIFRËS SË MINISTRISË  
SË MBROJTJES, DHE QEVERISË SË  
SHTETEVE TË BASHKUARA TË  
AMERIKËS, TË PËRFAQËSUAR NGA  
DEPARTAMENTI I MBROJTJES,  
AGJENCIA E SIGURISË KOMBËTARE /  
SHËRBIMI QENDROR I SIGURISË,  
DREJTORIA E SIGURISË KIBERNETIKE  
DHE AGJENCIA E SHPËRNDARJES DHE  
KONTABILITETIT TË KOMISIONIT  
USHTARAK, NATO (DACAN), NË LIDHJE  
ME DHËNIEN E PAJISJEVE DHE  
SHËRBIMEVE TË SIGURISË PËR  
KOMUNIKIMIN, NË KUADRIN E  
INFRASTRUKTURËS MENAXHERIALE  
TË KODUAR NË ORGANIZATËN E  
TRAKTATIT ATLANTIK VERIOR  
(NATO KMI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e memorandumit të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Drejtoria e Shifrës së Ministrisë së Mbrojtjes, dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të përfaqësuar nga Departamenti i Mbrojtjes, Agjencia e Sigurisë Kombëtare/Shërbimi Qendror i Sigurisë, Drejtoria e Sigurisë Kibernetike dhe Agjencia e Shpërndarjes

dhe Kontabilitetit të Komisionit Ushtarak, NATO (DACAN), në lidhje me dhënien e pajisjeve dhe shërbimeve të sigurisë për komunikimin, në kuadrin e infrastrukturës menaxheriale të koduar në Organizatën e Traktatit Atlantik Verior (NATO KMI), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Arben Ahmetaj**

**VENDIM****Nr. 720, datë 24.11.2021**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES  
PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE  
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,  
QË PREKEN NGA REALIZIMI I  
PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I  
RRUGËS ‘SABRI KOSTURI’, LUSHNJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugës “Sabri Kosturi”, Lushnjë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtësë jobanimi”, me një vlerë



të përgjithshme prej 5 020 078 (pesë milionë e njëzet mijë e shtatëdhjetë e tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 5 020 078 (pesë milionë e njëzet mijë e shtatëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Bashkisë Lushnjë.

8. Bashkia Lushnjë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Lushnjë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Lushnjë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Lushnjë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
Arben Ahmetaj

LISTA PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA RIKONSTRUKSIONI  
I RRUGËS “SABRI KOSTURI”, LUSHNJË

| Nr. | ZK   | Nr. i pasurisë | Adresa  | Pronari                                | Sipërfaqja truallit m <sup>2</sup> | Çmimi truallit lek/m <sup>2</sup> | Vlera e truallit lek | Sipërfaqe ndërtimi m <sup>2</sup> | Çmimi ndërtimit lek/m <sup>2</sup> | Vlera e ndërtimit lek | Vlera totale truall dhe ndërtimesë lek | Shënime                                                                                  |
|-----|------|----------------|---------|----------------------------------------|------------------------------------|-----------------------------------|----------------------|-----------------------------------|------------------------------------|-----------------------|----------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1   | 8572 | 24/11          | Lushnjë | Ilirjan Niazi Lika                     | 51                                 | 8,954                             | 456,654              | 50                                |                                    | 1,528,018             | 1,984,672                              | Shkresa e ASHK DV Lushnjë nr. 8465/1, datë 28.7.2021. Vërtetim hipotekor, datë 11.2.2021 |
| 2   | 8572 | 24/18          | Lushnjë | Andrea Aqif Kaja                       | 8                                  | 8,954                             | 71,632               |                                   |                                    |                       | 71,632                                 | Shkresa e ASHK DV Lushnjë nr. 8465/1, datë 28.7.2021. Vërtetim hipotekor datë 11.2.2021  |
| 3   | 8572 | 24/53          | Lushnjë | Fildus Batiar Beqiri dhe bashkëpronarë | 90                                 | 8,954                             | 805,860              |                                   |                                    |                       | 805,860                                | Shkresa e ASHK DV Lushnjë nr. 2240/1, datë 24.2.2021. Vërtetim hipotekor datë 11.2.2021  |
| 4   | 8572 | 10/35          | Lushnjë | Jorgo Zari Manoku dhe bashkëpronarë    | 14                                 | 8,954                             | 125,356              |                                   |                                    |                       | 125,356                                | Shkresa e ASHK DV Lushnjë nr. 8465/1, datë 28.7.2021. Vërtetim hipotekor datë 11.2.2021  |
| 5   | 8572 | 14/210         | Lushnjë | Niazi Beqir Liçi                       | 75                                 | 8,954                             | 671,550              |                                   |                                    |                       | 671,550                                | Shkresa e ASHK DV Lushnjë nr. 8465/1, datë 28.7.2021. Vërtetim hipotekor datë 11.2.2021  |
| 6   | 8572 | 14/209         | Lushnjë | Dashnor Beqir Liçi                     | 76                                 | 8,954                             | 680,504              |                                   |                                    |                       | 680,504                                | Shkresa e ASHK DV Lushnjë nr. 8465/1, datë 28.7.2021. Vërtetim hipotekor datë 11.2.2021  |
| 7   | 8572 | 24/27          | Lushnjë | Petrit Hajdar Muço dhe bashkëpronarë   | 10                                 | 8,954                             | 89,540               |                                   |                                    |                       | 89,540                                 | Shkresa e ASHK DV Lushnjë nr. 8465/1, datë 28.7.2021. Vërtetim hipotekor datë 11.2.2021  |
| 8   | 8572 | 24/25          | Lushnjë | Petrit Hajdar Muço dhe bashkëpronarë   | 12                                 | 8,954                             | 107,448              |                                   |                                    |                       | 107,448                                | Shkresa e ASHK DV Lushnjë nr. 8465/1, datë 28.7.2021. Vërtetim hipotekor datë 11.2.2021  |
| 9   | 8572 | 24/56          | Lushnjë | Jashar Arif Muço dhe bashkëpronarë     | 54                                 | 8,954                             | 483,516              |                                   |                                    |                       | 483,516                                | Shkresa e ZVRPP Lushnjë nr. 7791, datë 24.2.2019. Vërtetim hipotekor datë 17.12.2021     |
|     |      |                |         |                                        |                                    |                                   |                      |                                   |                                    | SHUMA                 | 5,020,078                              |                                                                                          |

**VENDIM**

Nr. 721, datë 24.11.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 221, DATË 12.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR EMËRIMIN E KRYETARIT DHE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 10233, datë 11.2.2010, “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në pikën 1, të vendimit nr. 221, datë 12.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, z. Etjen Xhafaj, anëtar, zëvendësohet me z. Genc Resuli.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**

**VENDIM**

Nr. 722, datë 24.11.2021

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË DREJTORIT EKZEKUTIV TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të ligjit nr. 10233, datë 11.2.2010, “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Znj. Edlira Kraja, drejtor ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**

**VENDIM**

Nr. 723, datë 24.11.2021

**PËR EMËRIMIN E DREJTORIT EKZEKUTIV TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 10233, datë 11.2.2010, “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Z. Maksim Et'hemaj emërohet drejtor ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Arben Ahmetaj**

**VENDIM**

Nr. 724, datë 24.11.2021

**PËR PËRJASHTIMIN NGA PROCEDURA E PËRZGJEDHJES NGA MËSUESIT NË BAZË SHKOLLE TË TEKSTIT TË ABETARES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përfshirjen nga procedura e përzgjedhjes nga mësuesit në bazë shkolle të tekstit të abetares dhe unifikimin e saj si tekst i vetëm “Abetare”, për të gjithë nxënësit në institucionet e arsimit parauniversitar.

2. Teksti i vetëm “Abetare” sigurohet nga botues, mbi bazën e standardeve të teksteve shkollore, nëpërmjet një konkurrimi të hapur, të barabartë dhe transparent, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.



3. Teksti i vetëm “Abetare” do të përdoret në sistemin arsimor parauniversitar, duke filluar nga viti shkollor 2022–2023, e në vijim.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Arben Ahmetaj**

**VENDIM**  
**Nr. 725, datë 24.11.2021**

**PËR FUNKSIONIMIN, ORGANIZIMIN  
DHE VEPRIMTARINË E MUZEUT  
KOMBËTAR TË PAVARËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 209, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Përcaktimin e funksionimit, organizimit e të mënyrës së zhvillimit të veprimtarisë së Muzeut Kombëtar të Pavarësisë.

2. Muzeu Kombëtar i Pavarësisë është person juridik, publik, buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me seli në Vlorë. Muzeu Kombëtar i Pavarësisë është institucion i specializuar në fushën muzeore dhe ka statusin “Muze kombëtar”.

3. Mjediset, ku ushtron veprimtarinë Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, janë në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

4. Misioni i Muzeut Kombëtar të Pavarësisë është përkujtimi dhe promovimi i vlerave të periudhës historike të shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptar, trashëgimisë historike, që lidhet me një nga ngjarjet më të rëndësishme të Shqipërisë, shpalljen e Pavarësisë më 28 Nëntor 1912, si një nga momentet më të rëndësishme në historinë e kombit shqiptar.

5. Burimet e financimit të Muzeut Kombëtar të Pavarësisë janë:

- a) buxheti i shtetit;
- b) burime të tjera sipas legjislacionit në fuqi.

**II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË MUZEUT KOMBËTAR TË PAVARËSISË**

Muzeu Kombëtar i Pavarësisë ka përgjegjësi funksionale të organizojë punën për të siguruar:

a) dokumentimin e fakteve historike, lidhur me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe krijimin e shtetit shqiptar në vitin 1912, nëpërmjet studimit, kërkimit, arkivimit të këtyre fakteve, si dhe bashkëpunimit me subjekte publike e private, shqiptare apo të huaja;

b) ruajtjen e trashëgimisë kulturore, lidhur me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe krijimin e shtetit shqiptar në vitin 1912;

c) ofrimin e shërbimit për publikun dhe promovimin e publikimin e fakteve historike, lidhur me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe krijimin e shtetit shqiptar në vitin 1912.

**III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I MUZEUT KOMBËTAR TË PAVARËSISË**

1. Muzeu Kombëtar i Pavarësisë e shtrinë veprimtarinë për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.

2. Struktura dhe organika e Muzeut Kombëtar të Pavarësisë miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

3. Muzeu Kombëtar i Pavarësisë kryen këto detyra:

a) zbaton politikën e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në fushën e trashëgimisë kulturore dhe të muzeologjisë, me qëllim ruajtjen, mbrojtjen, ekspozimin, pasurimin, propagandimin, studimin, restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe historike;

b) ruan dhe studion provat materiale dhe jomateriale të trashëgimisë historike dhe kulturore të Shqipërisë, të cilat i komunikon dhe i paraqet në një mjedis që nxit edukimin dhe argëtimin;

c) merr të gjitha masat për të siguruar disponueshmërinë e koleksioneve të muzeve për vizitorët dhe studiuesit;

ç) u ofron personave të të gjitha moshave mundësi për të mësuar nëpërmjet kontaktit me materiale origjinale, edhe duke bashkëpunuar me subjektet arsimore;



d) organizon aktivitete, të cilat përmbushin vizionin e misionin e tij në përkujtimin e ditës së Pavarësisë dhe krijimin e shtetit shqiptar në vitin 1912;

dh) organizon brenda dhe jashtë vendit çeljen e ekspozitave me objektet që disponon, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

e) përgatit pasaportën shkencore të çdo objekti ekzistues apo të ri, që bëhet pjesë e fondit të tij, dhe ia përcjell për regjistrim institucionit përgjegjës për regjistrimin e trashëgimisë kulturore;

ë) kryen hulumtime profesionale dhe shkencore për mbledhjen, vlerësimin e ekspozimin e objekteve që disponon;

f) nxit e inkurajon, nëpërmjet projekteve, veprimtarinë kërkimore-shkencore, lidhur me fondet që administrojnë për studiuesit në fushën e historisë dhe punonjësit në fushën e muzeologjisë;

g) inkurajon dialogun me dhe ndërmjet qytetarëve për të kaluarën, të tashmen e të ardhmen shqiptare.

4. Muzeu Kombëtar i Pavarësisë e realizon veprimtarinë e tij në bashkëpunim me:

a) organet e administratës shtetërore qendrore dhe organet e vetëqeverisjes vendore;

b) rrjetin muzeor shqiptar;

c) muzetë kombëtarë, muzetë qendrorë, muzetë vendorë, muzetë autonome, muzetë privatë, për të tërhequr në fondet e tij objekte me vlera të veçanta, si edhe për ekspozita e aktivitete të tjera të përbashkëta;

ç) institucione shkencore, kulturore, artistike dhe fetare, individë, persona fizikë dhe juridikë, privatë, për evidentimin, grumbullimin e restaurimin e objekteve, pjesë e fondit të tij, që janë vlera materiale të trashëgimisë kulturore dhe muzeologjisë;

d) institucione të huaja simotra nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare, duke marrë në çdo rast miratimin e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

5. Statuti dhe rregullorja që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të Muzeut Kombëtar të Pavarësisë miratohen nga ministri, me propozimin e drejtorit të muzeut.

6. Marrëdhëniet juridike të punës së drejtorit, të nëpunësve dhe të punonjësve të Muzeut Kombëtar të Pavarësisë rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

7. Muzeu Kombëtar i Pavarësisë drejtohet nga drejtori i muzeut, i cili organizon e drejton të gjithë veprimtarinë e institucionit dhe përgjigjet përpara ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

8. Drejtori i Muzeut Kombëtar të Pavarësisë emërohet ose lirohet nga detyra nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, sipas kriterëve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Muzeve. Drejtori emërohet për një mandat trevjeçar. Procedura e emërimit dhe e lirimit të tij përcaktohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore në rregulloren për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit.

9. Drejtori i Muzeut Kombëtar të Pavarësisë ka kompetencat, si më poshtë vijon:

a) drejton veprimtarinë e Muzeut Kombëtar të Pavarësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin e institucionit dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të tij;

b) përfaqëson Muzeun Kombëtar të Pavarësisë në marrëdhëniet me të tretët;

c) ka të drejtë të lidhë marrëveshje për shkëmbimin e fondeve muzeore, pas marrjes së miratimit nga Këshilli Kombëtar i Muzeve. Procedura e ndjekur në këtë rast bëhet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;

ç) merr masa mbrojtëse dhe ruajtjeje lidhur me fondin kombëtar të muzeut;

d) emëron e liron nga detyra të gjithë punonjësit e muzeut, në përputhje me ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punës;

dh) nxjerr urdhra dhe udhëzime me karakter të brendshëm për punonjësit e Muzeut Kombëtar të Pavarësisë;

e) çdo kompetencë tjetër në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

10. Muzeu Kombëtar i Pavarësisë ka stemën, logon dhe vulën e tij zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria e ... (emri i ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore), Muzeu Kombëtar i Pavarësisë”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave, për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.



11. Vula e Muzeut Kombëtar të Pavarësisë ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave. Vula prodhohet, administrohet e ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Deri në miratimin e strukturës dhe të organikës së re të muzeut, sipas këtij vendimi, Muzeu Kombëtar i Pavarësisë do të funksionojë sipas strukturës e organikës në fuqi.

2. Vendimi nr. 293, datë 17.5.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen ‘Kombëtar’ të Muzeut të Pavarësisë, Vlorë dhe për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të tij, nga Bashkia e Vlorës në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, si dhe institucionet e tjera në fushën e trashëgimisë kulturore dhe muzeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Arben Ahmetaj**

**URDHËR**  
**Nr. 302, datë 24.11.2021**

#### **PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 21, shkronja “a”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 30, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, për shkak të mungesës së Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së përfaqësimit të institucionit në marrëdhëniet me palët e treta, znj. Laerta Rooze, Sekretare e Përgjithshme e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

2. Delegimin e kompetencës së mësipërme në datën 26.11.2021.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, znj. Laerta Rooze.

4. Znj. Laerta Rooze nuk mund ta nëndelegojë këtë kompetencë.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOLEGJIT TË  
POSAÇËM TË APELIT  
**Albana Shtylla**

**URDHËR**  
**Nr. 370, datë 26.11.2021**

#### **PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; dhe të nenit 11, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Brendshme, zëvendësministrit të Brendshëm, znj. Romina Kuko, nga data 29.11.2021 deri më datë 1.12.2021.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Brendshëm, znj. Romina Kuko.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM  
**Bledar Çuçi**





*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë